

EKONOMI DHE FINANCE

# SISTEMI EKONOMIK DHE ROLI I SHTETIT NË SHOQËRI

Opinione dhe qëndrime të publikut shqiptar

**Selami Xhepa**  
**Adrian Civici**  
Janar 2021



Matja e perceptimeve të publikut, si dhe vlerësimet empirike dhe teorike tregojnë se mënyra e funksionimit të sistemit ekonomik në Shqipëri është shumë e anësuar.



Nevojitet rishikimi i politikave, praktikave dhe institucioneve për të ndërtuar një shoqëri më kohezive dhe më të shëndetshme nëpërmjet rritjes dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm e cilësor.



Debati publik duhet orientuar rreth mënyrës se si mund të reformohet sistemi i sotëm ekonomik, në mënyrë që të jetë më i balancuar nga pikëpamja e interesave sociale.

EKONOMI DHE FINANCE

# SISTEMI EKONOMIK DHE ROLI I SHTETIT NË SHOQËRI

Opinione dhe qëndrime të publikut shqiptar



Programi «Economy for All» është një iniciativë e Fondacionit «Friedrich Ebert» që synon të ridimensionojë rolin e aktorëve ekonomikë dhe shoqërorë për të hedhur bazat e krijimit të një modeli të ri social-ekonomik. Iniciativa e FES-it mbështetet plotësisht në ekspertizën e anëtarëve të grupit të ekspertëve, të cilët gjithashtu kanë reflektuar mbi studimin që ju tashmë keni në dorë.

FES-i falënderon grupin e punës të «Economy for All»: Prof. Dr. Adrian Civici, Daniel Guçe, Irena Beqiraj, Ornela Liperi dhe Prof. As. Dr. Selami Xhepa, për angazhimin e plotë dhe vullnetin e mirë për një investim serioz drejt një modeli social-ekonomik për vendin tonë.

# Përmbajtja

<b>1.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	5
<b>2.</b>	<b>METODOLOGJIA E STUDIMIT</b> .....	7
2.1	Pyetësi .....	7
2.2	Kampionimi .....	8
<b>3.</b>	<b>RRITJA EKONOMIKE, VARFËRIA DHE PABARAZIA</b> ..	11
<b>4.</b>	<b>INDIVIDUALIZMI DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE</b> .....	20
<b>5.</b>	<b>ROLI I SHTETIT PËRBALLË PASIGURIVE NË RRITJE</b> ...	23
<b>6.</b>	<b>QASJA NDAJ PROCESEVE TË RAJONALIZIMIT DHE INTEGRIMIT</b> .....	29
<b>7.</b>	<b>VLERËSIME TË PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIME PËR POLITIKËBËRJEN</b> .....	33
	<b>REFERENCA</b> .....	36
	<b>ANEKSI 1: PYETËSORI</b> .....	37
	<b>ANEKSI 2: REZULTATET E PËRMBLEDHURA TË PYETËSORIT</b> .....	39



## 1

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij raporti studimor është analiza e perceptimeve të publikut mbi mënyrën e funksionimit të sistemit ekonomik e shoqëror, raportet ndërmjet shtetit dhe tregut, ndryshimet në sistemin e vlerave shoqërore që mund të jenë ravijëzuar gjatë tri dekadave të tranzicionit drejt një sistemi demokratik dhe ekonomisë së tregut, si dhe vlerësimet e publikut lidhur me proceset integruese në të cilat është angazhuar vendi.

Tashmë Shqipëria ka hyrë në dekadën e katërt të përpjekjeve të saj për të ndërtuar një shoqëri të lirë demokratike, bazuar në shtetin ligjor dhe ekonominë e tregut të lirë. Arritjet e derisotme janë të dukshme dhe u dedikohen kryesisht iniciativës së lirë dhe punës së qytetarëve të vendit, të mbështetura nga reformat transformuese të ndërmarra nga lidershipi politik i vendit. Nga ana tjetër, dështimet e tregut janë të natyrshme edhe në kontekstin e një shoqërie me institucione demokratike funksionale, prandaj lind nevoja e rishikimit të politikave, praktikave dhe institucioneve, me objektivin që të ndërtohet një shoqëri më kohezive dhe më e shëndetshme, nëpërmjet një rritjeje dhe zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe cilësor. Prej kohësh në Shqipëri është hapur një debat për «modelin e ri ekonomik të zhvillimit», por deri më sot ky debat është kufizuar thjesht në aspektin sektorial të rritjes, një qasje që është kryesisht pozitiviste dhe që nënvizon përmirësimin e ritmeve të rritjes nëpërmjet alokimeve të burimeve në sektorë të caktuar (për shembull, eksportet). Ky material propozon një qasje tjetër në orientimin e debatit publik, atë mbi mënyrën se si mund të reformohet sistemi i sotëm ekonomik, në mënyrë që të jetë më i balancuar nga pikëpamja e interesave socialë, pra, një qasje normative.

Studimi bazohet në premisën e testuar si nëpërmjet një pyetësori të realizuar me mbështetjen e këtij projekti kërkimor, ashtu dhe nëpërmjet analizave empirike dhe teorike, se zhvillimi ekonomik i vendit ka krijuar diferenca të mëdha sociale dhe se një shoqëri harmonike dhe kohezive është thelbësore si për të rritur cilësinë e jetës në vend, ashtu dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e vetë sistemit ekonomik e shoqëror në afat të gjatë.

Disa nga gjetjet kryesore të këtij studimi janë:

- Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 66% të totalit (2 në 3 banorë), janë përgjigjur se **shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave dhe pasurisë në Shqipëri po bëhet gjithnjë e më shumë një problem për kohezionin social të popullsisë**. Po ashtu, 39% e tyre mendojnë se **pasuria e krijuar nga të pasurit nuk është vënë me anë të punës së ndershme**.
- Gjithashtu, opinioni publik (43.50%) beson se politikat e derisotme u kushtojnë më shumë vëmendje interesave të sektorit privat dhe pak vëmendje interesave të popullatës. Pra, **sistemi është i disbalancuar në favor të kapitalit**.
- Edhe pse më shumë se 40% e popullatës besojnë se individët duhet të marrin më shumë përgjegjësi mbi vete, përsëri **vetëm rreth 30% e tyre mbështetin një shoqëri të bazuar mbi individualizmin**. Nevoja për ndërhyrje shtetërore në mbrojtjen e vendeve të punës që rrezikohen dhe në investimet publike në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë mbështetet në mënyrë masive.
- Shoqëria beson se **rreziqet për rënien e standardit të mirëqenies janë sot më të larta nga ato të brezit të kaluar dhe se rreziqet për brezin e ardhshëm do të jenë edhe më të larta. Pra, rreziku i perceptuar vjen në rritje**.
- Shoqëria i mbështet fuqimisht proceset e integritit të vendit dhe shumica (mbi 65%) vlerësojnë se **efektet e marrëveshjeve të tregtisë së lirë kanë qenë me avantazhe pozitive**. Por qytetarët vlerësojnë se, pavarësisht nga thellimi i proceseve të integritit, politika lokale duhet gjithashtu të ketë **kontroll mbi legjislacionin e vendit**.
- Të gjitha konkluzionet e mësipërme ndahen njësoj nga të gjitha kategoritë e popullsisë. Nuk shfaqen dallime thelbësore midis grupeve të ndryshme të popullsisë

të klasifikuara sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit të të ardhurave dhe vendbanimit të tyre. Diferenca të lehta shfaqen ndërmjet dy grupmoshave në skajet e piramidës moshore, të moshave 18–29 vjeç dhe mbi 60 vjeç, të cilat mund të reflektojnë kontekstet e ndryshme ekonomike e sociale të zhvillimit të personalitetit të tyre dhe të sistemeve të vlerave që kanë karakterizuar dy regjime të ndryshme në të cilat ato janë zhvilluar.

Që ekonomia e nesërme të mos jetë një ekonomi e normave të ulëta të rritjes, e produktivitetit të ulët, e pabarazive të larta dhe e një mjedisi të degraduar, duke lexuar me vëmendje mendimet e publikut dhe mësimet e

nxjerra nga provat empirike, studimi ofron rekomandime për reformat e nevojshme nga politikëbërësit. Ndërhyrjet politike të synuara janë strukturuar përgjatë dy akseve: (1) Politika për **kontrollin e proceseve** që prodhojnë pabarazi dhe rritje ekonomike jopërfshirëse dhe (2) Politika për **korrektimin e rezultateve** që krijohen nga shpërndarja ekonomike. Ndërsa reformat e grupit të parë synojnë përmirësimin e qeverisjes ekonomike në mënyrë që rezultatet ekonomike të krijohen sipas proceseve të ndershme të ligjësive të tregut të lirë dhe konkurrues, reformat e grupit të dytë synojnë të krijojnë mekanizma të korrektimit të deformimeve që mund të manifestohen në shpërndarjen e së ardhurës kombëtare.

## 2

## METODOLOGJIA E STUDIMIT

Në mënyrë që të sigurohej informacion sa më i plotë dhe i saktë, është përdorur metoda mikse e hulumtimit, duke shfrytëzuar të dhëna sasiore dhe cilësore.

Pjesa sasiore e studimit u fokusua në një pyetësor të targetuar kundrejt popullatës së kampionuar në 12 qarqet e Shqipërisë. Pyetësi i përgatitur u shpërnda dhe u plotësua nëpërmjet platformës *online* «Google Form».

### Mbledhja e të dhënave sasiore

Në mënyrë që të sigurohej mbledhja e të dhënave sasiore nga biznesi në secilën bashki, si dhe përfaqësueshmëria, është ndjekur metoda kërkimore deskriptive ndërseksionale, që ofron informacione në një moment të caktuar kohor rreth ekzistencës dhe impaktit të politikave në raport me qëndrimet mbi situatën ekonomike në Shqipëri dhe integrimin rajonal. Kjo metodë hulumtuese është zgjedhur pasi ofron disa avantazhe në krahasim me metoda të tjera. Për shembull:

- është e shpejtë për t'u zhvilluar;
- të gjithë variablat mblidhen në të njëjtën kohë;
- mund të matë disa rezultate njëherësh;
- prevalenca për të gjithë faktorët është e matshme;
- është metodë e mirë për mbledhjen e të dhënave deskriptive;
- mund të përdoret për hulumtime të mëtejshme.

Të gjitha të dhënat e përfuara nga përgjigjet e të anketuarve janë përpunuar dhe analizuar nëpërmjet softueveve analitike të të dhënave, si SPSS-ja dhe MAXQDA-ja, nëpërmjet të cilave është realizuar përpunimi cilësor dhe sasior i të dhënave.

### Metoda cilësore – shfletim dokumentesh dhe analizim rrethanash socio-ekonomike dhe i zbatimit të politikave ekonomike

Për të legjitimuar, por dhe për të kontrolluar gjetjet sasiore të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve, na shërben pjesa cilësore e raportit, rezultat i shfletimit të të gjitha materialeve dhe informacioneve zyrtare në nivel lokal dhe qendror për sa u përket temave kryesore të trajtuara në raport. Të dhënat e mbledhura me anën e metodave të

mësipërme janë përdorur gjerësisht në arsyetimet lidhur me interpretimin e rezultateve të pyetësorit.

### 2.1 PYETËSORI

Pyetësi i përdorur për këtë studim përbëhet nga pyetje me zgjedhje të shumëfishta (duke përfshirë këtu mundësinë e pyetjeve demografike/gjeografike dhe administrative). Pyetjet janë të tipit të strukturuar dhe kanë përmbajtje të tillë që jo vetëm të testojnë dhe të marrin të dhëna lidhur me subjektin e pyetësorit tonë, por edhe t'i verifikojnë përgjigjet me pyetje kontrolluese brenda pyetësorit, për të pasur më shumë saktësi në përgjigjet e marra.

Të intervistuarit janë zgjedhur në mënyrë rastësore nga anketuesit, brenda kuadrit të kampionimit. Për realizimin e këtij pyetësi janë angazhuar 13 anketues, nga një për secilin qark të Shqipërisë (me përjashtim të Tiranës, ku, për shkak të sasisë së madhe kampionuese, nevojitej të angazhoheshin 2 anketues), të cilëve, bazuar dhe në të dhënat e INSTAT-it mbi popullsinë, gjininë dhe shpërndarjen gjeografike brenda secilit qark, u është përgatitur kampionimi dhe u është kërkuar respektimi i tij në mënyrë rigoroze.

Për sa i përket metodës trajnuese dhe kontrolluese për realizimin e pyetësorit, janë realizuar një sërë takimesh me anketuesit, ku, fillimisht, përpara se të dalin në terren për të intervistuar, u është kërkuar të njihen me pyetësin, janë trajnuar për mënyrën si duhet të komunikojnë me të intervistuarit dhe për pjesën teknologjike të realizimit të pyetësorit.

Kontrollimi i aktivitetit intervistues për secilin prej anketuesve është realizuar nëpërmjet:

- Shpërndarjes së lokacioneve *live* nga të gjithë anketuesit në orarin e realizimit të intervistave;
- Raporteve gjysmëformale pas çdo 1 ore ose 2 orësh pune në terren, raporteve formale ditore, si dhe raportit përfundimtar përmbljedhës;
- Për secilin person të intervistuar, që nuk e ka pasur problem identifikimin, është mbajtur shënim emri, mbiemri dhe numri i telefonit, në rast nevojë kontrolli.

## 2.2 KAMPIONIMI

Për të llogaritur kampionin është përdorur formula e Cochran-it:

$$n_0 = \frac{z^2 p (1-p)}{e^2}$$

ku  $z$  tregon intervalin e besueshmërisë,  $p$  është proporcioni i popullsisë me atributin që duam të studiojmë, dhe  $e$  është marzhi i gabimit për madhësinë e popullsisë  $N$  që prodhon ekuacionin e mëposhtëm:


$$n = \frac{n_0}{1 + \frac{n_0 - 1}{N}}$$

Për llogaritja e përmasës së kampionit bëhet nëpërmjet formulës së mësipërme të Cochran-it, duke përdorur një nivel besueshmërie prej 95% (me marzh gabimi 5%), në mënyrë që të jetë statistikisht e vlefshme.

Bazuar në të dhënat vjetore të INSTAT-it mbi popullsinë sipas qarqeve, u konkludua ky kampion për çdo qark, duke mbajtur parasysh dhe duke respektuar raportet e numrit të popullatës, gjinisë, moshës dhe shpërndarjes gjeografike për çdo qark.

Studimi synon të nxjerrë në pah veçantitë e qëndrimeve mbi funksionimin e sistemit ekonomik e shoqëror, si dhe proceset e integritit, bazuar në disa karakteristika specifike, siç janë: gjinia, struktura moshore, niveli i të ardhurave, raportet me tregun e punës dhe të ardhurat shitesë nga emigracioni dhe banorët e zonave rurale me ata të zonave urbane<sup>1</sup>. Shpërndarja e popullatës së të intervistuarve sipas këtyre karakteristikave paraqitet në grafikët vijues.

Grafiku 1:  
**Shpërndarja e popullatës së të intervistuarve sipas gjinisë**




Qarku	Burra	Gra	Gjithsej
Berat	30	28	58
Dibër	28	26	54
Durrës	65	63	128
Elbasan	59	61	120
Fier	65	63	128
Gjirokastrë	15	15	30
Korçë	45	47	92
Kukës	20	18	38
Lezhë	29	29	58
Shkodër	44	50	94
Tiranë	190	197	387
Vlorë	41	40	81
<b>Gjithsej</b>	<b>631</b>	<b>637</b>	<b>1,268</b>


1 Të dhënat statistikore të plota janë të disponueshme për të interesuarit dhe mund të sigurohen duke iu drejtuar zyrës së FES-it në Tiranë.



Grafiku 2:


**Shpërndarja e popullatës së të intervistuarve sipas strukturës moshore**

Grafiku 3:

**Shpërndarja e popullatës së të intervistuarve sipas situatës së punësimit**


Grafiku 4:

**Shpërndarja e popullatës së të intervistuarve sipas nivelit të të ardhurave**




Grafiku 5:

**Shpërndarja e popullatës së të intervistuarve sipas të ardhurave shtesë nga emigracioni**



Grafiku 6:

**Shpërndarja e popullatës së të intervistuarve sipas vendbanimit**



## 3

## RRITJA EKONOMIKE, VARFËRIA DHE PABARAZIA

Përshpejtimi i procesit të rritjes ekonomike përbën një ndër çështjet politike më të rëndësishme të teorisë së ekonomisë. Arsyeja është se rritja ekonomike kushtëzon zhvillimin ekonomik të një vendi dhe bashkë me të, standardin e jetesës së popullsisë. Por jo gjithmonë rritja ekonomike përkthehet në zhvillim ekonomik dhe standard më të lartë mirëqenieje. Janë jo të pakta rastet në historinë e ekonomisë ku rritja ekonomike nuk ka çuar edhe në progres ekonomik e shoqëror, dhe kjo për shkak të cilësisë së kësaj rritjeje.

Pra, e rëndësishme është që vendi të gëzojë jo vetëm rritje ekonomike, por dhe që kjo të jetë cilësore, një rritje nga e cila përfitojnë të gjitha grupet shoqërore, një rritje që i ngushton pabarazitë sociale dhe e zbut varfërinë. Pabarazia dhe varfëria janë parë si mallkimi binjak që shpeshherë fajësohet si shkaktari i së keqes që kontribuon jo vetëm në përkeqësimin e treguesve të shëndetit, por edhe minon qeverisjen demokratike, gërryen besimin dhe kënaqësinë e shoqërisë, madje bëhet shkas edhe për obezitetin në rritje të popullsisë<sup>2</sup>.

Problemet e pabarazisë ekonomike për shoqërinë janë serioze dhe afatgjata. Një shikim i shpejtë në historinë e shkuar na tregon se pabarazitë në rritje kanë çuar në rënien e kombeve të zhvilluara, ku mund të përmendim episodet historike të Amsterdemit në shekullin XVIII dhe të Venecies në shekullin XVII. Madje një historian do të konkludonte se, pasi krijohen, pabarazitë mund të zhbëhen vetëm me një tronditje të fortë e të dhunshme sociale. Në fakt, eksperiencia e Britanisë së Madhe gjatë Revolucionit të Parë Industrial tregon për një skenar jo kaq pesimist; reformimi i institucioneve dhe ndërtimi i një shoqërie më kohezive mund të realizohen edhe me metoda jorevolucionare. Shqyrtimi i eksperiencave historike të vendeve të zhvilluara e ndihmoi një nga autoritetet e padiskutueshme shkencore në fushën e pabarazisë dhe të varfërisë, Sër Anthony Atkinson-in,

të arrinte në përfundimin se pabarazitë në të ardhura luhaten në mënyrë të çrregullt, duke gjurmuar sekuenca episodesh më shumë se prirje afatgjata të mirëpërcaktuara (Atkinson, 1997)<sup>3</sup>.

Pabarazia ekonomike, veçanërisht ajo ekstreme, mund të rezultojë në privim kronik të të drejtave të njeriut. Studime të shumta kanë provuar se ajo është një ndër shkaqet kryesore që pengon funksionimin e shtetit të së drejtës – duke favorizuar kapjen e shtetit dhe të vendimmarrjes, pabarazia ekonomike pengon zhvillimin ekonomik të vendeve dhe kthehet në burim konfliktesh civile dhe paqëndrueshmëri sociale.

Debati mbi pabarazitë është një temë qendrore në debatin e sotëm politik global. Ka një ndjesi gjithnjë në rritje se të varfërit po lihen pas nga të pasurit, të moshuarit nga të rinjtë, periferitë nga metropolet, individët pa shkollë nga ata me shkollime të mira, vendet e varfra nga vendet e pasura. Hendeku ekonomik dhe social ndërmjet kombeve, rajoneve dhe grupeve sociale po thellohet.

Ky problem ndeshet gjerësisht edhe në vendin tonë, dhe debatet mbi pabarazitë në rritje dhe varfërinë janë shumë të pranishme në shoqëri. Edhe ky studim konfirmon se publiku ka qartazi një perceptim se shpërndarja e pasurisë dhe e të ardhurave ka krijuar pabarazi të mëdha dhe se kjo përbën një shqetësim serioz për kohezionin social.


Pyetjes «A po bëhet shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave dhe pasurisë në Shqipëri gjithnjë e më shumë një problem për kohezionin social të popullsisë?», rreth 70% e të intervistuarve i janë përgjigjur se «pajtohen plotësisht» dhe 92% i janë përgjigjur «po dhe më shumë po». Përgjigjet e dhëna nuk shfaqin dallime të rëndësishme sipas gjinisë, nivelit të të ardhurave, grupmohës apo vendbanimit. Ky nivel kaq i lartë perceptimi mbi asimetrinë e shpërndarjes së të ardhurave dhe pasurisë është realisht shqetësues.

<sup>2</sup> Anne Case, Angus Deaton, 2020, Deaths of Despair and the Future of Capitalism, Princeton University Press.

<sup>3</sup> Atkinson, A B (1997), Bringing Income Distribution in from the Cold, Economic Journal 107: 297-321.

Grafiku 7:

**Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?**



Por, a është çështja e varfërisë dhe pabarazisë thjesht një problem perceptimesh, apo një realitet që provohet dhe nga të dhënat empirike? Si ka lindur pabarazia në Shqipëri?

Tabela 1:  
**Indeksi i koeficientit Gini, 1996–2017**

Vitet	Indeksi
1996	27.0
2002	31.7
2005	30.6
2008	30.0
2012	29.0
2014	34.6
2015	32.9
2016	33.7
2017	33.2

Burimi: Baza e të dhënave e Bankës Botërore

Tabela 2:  
**Shpërndarja e të ardhurave, 2014–2017**

	2014	2015	2016	2017
Të ardhurat e top 10%	25.5	24.9	25	24.8
Të ardhurat e bottom 10%	2.9	3.1	3	3.1
Të ardhurat e top 20%	41.7	40.8	41.1	40.7
Të ardhurat e bottom 20%	7	7.7	7.3	7.5

Burimi: Baza e të dhënave e Bankës Botërore


Nga një vend egalitarian dhe me pabarazi të papërfillshme në fillimet e tranzicionit, pabarazitë kanë ardhur duke u thelluar. Në veçanti procesi i krijimit të pasurisë ka sjellë formimin e grupeve të polarizuara shoqërore për sa i përket përqendrimit të pasurisë. E matur me diferencat e konsumit midis kuantileve dhe decileve të poshtme dhe të larta në shpërndarjen e të ardhurave, rezultojnë se kjo diferencë ka mbetur e stabilizuar në nivele relativisht të larta për një periudhë relativisht të gjatë kohe. Po kështu, edhe indeksi i koeficientit Gini<sup>4</sup>, që mat pabarazinë në të ardhura, ka një vlerë të lartë, në rreth 33%.

Siç shihet nga të dhënat e kësaj table, 10% e popullsisë marrin rreth 1/4 e së ardhurës kombëtare të krijuar dhe 20% e saj marrin rreth 41% të gjithë të ardhurave të ekonomisë. Ndërsa 10% e popullsisë që ndodhen në fundin e piramidës së shpërndarjes së të ardhurave marrin vetëm rreth 3% të të ardhurave, ose rreth 8 herë më pak se 10% që janë në majë të piramidës; rreth 1/5 e popullsisë që ndodhen në shtresën e fundit të piramidës së shpërndarjes së të ardhurave marrin vetëm 7.5% të së ardhurës kombëtare të krijuar gjatë vitit.

E parë në një kontekst krahasues, kjo vlerë e indeksit të koeficientit Gini, e rendit Shqipërinë ndër vendet me nivele të larta pabarazie, krahas vendeve si Britania e Madhe apo Spanja. Problemi në Shqipëri bëhet edhe më i

4 Ky indeks merr vlerën nga 0, barazi e plotë (çdo 1% e popullsisë zotëron 1% të pasurisë), në 1, që shpreh pabarazinë ekstreme (ku 1 individ zotëron 100% të pasurisë).

Figura 1:  
**Koeficienti Gini i të ardhurave familjare neto të ekuivalentuara në vende të përzgjedhura, 2016**



Burimi: *Inequalities in the 21<sup>st</sup> century*, Instituti për Studime Fiskale, maj 2019


mprehtë pasi kontrastet sociale bëhen shumë të dukshme në kuadrin e një varfërie gjerësisht të përhapur, siç edhe e diskutuam më sipër në kontekstin e Paradoksit Easterlian.

Edhe këto evidenca të mësipërme, përputhen dhe mbështetin perceptimin e publikut lidhur me shtimin e pabarazive sociale dhe dëmtimin e kohezionit social.

Një pyetje tjetër që mund të shtrojmë është se, **kur ekonomia shënon rritje të lartë, a përkthehet**

**ajo në më shumë mirëqenie për individin?** Me fjalë të tjera, nëse vendi do të siguronte norma të larta rritjeje ekonomike, a do të kontribuonte kjo në reduktimin e varfërisë nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim dhe aktivitet ekonomik për individin? Sipas rezultateve të pyetësorit, **1 në 3 persona beson se rritja ekonomike krijon përfitime për shoqërinë**, çka është një tregues shumë pozitiv për cilësinë e rritjes.

Grafiku 8:  
**Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?**



Në veçanti grupmosha 30–44 vjeç shprehet më optimiste, ndërsa dy grupmoshat ekstreme, ato në intervalet 18–24 vjeç dhe mbi 60 vjeç, janë më pak optimiste. Kjo mund t'i atribuohet faktit se në grupmoshën 30–44 vjeç individit arrin të maksimizojë të ardhurat e tij, qoftë për shkak të arsimimit, por dhe të eksperiencave të fituara, ndërsa te të rinjtë që sapo kanë hyrë në tregun e punës apo te moshat e mëdha, kurba e të ardhurave nga njëra anë nisët nga një pikë e ulët dhe vjen në ngjitje teksa i afrohen grupmoshës 30-vjeçare dhe në anën tjetër vjen në rënie teksa grupmosha mbi 60 vjeç përgatitet të dalë nga tregu i punës.


Përtej këtyre dallimeve sipas grupmoshave, duhet theksuar se perceptimi në tërësi mund të konsiderohet si pozitiv. Ky perceptim pozitiv për rolin e rritjes ekonomike në mirëqenien e shoqërisë merr gjithashtu mbështetje nga të dhënat empirike. Një paraqitje e thjeshtë grafike midis rritjes ekonomike gjatë viteve dhe reduktimit/shtimit të popullsisë së varfër tregon për një lidhje negative, me një koeficient korrelacioni -0.12, që do të thotë se periudhat e rritjes ekonomike janë shoqëruar me reduktim të varfërisë në vend. Trendet janë veçanërisht të qarta pas vitit 2002, kur vendi zbatoi për herë të parë politika publike të fokusuar në trajtimin e këtij problemi, në kuadër të strategjisë së reduktimit të varfërisë sipas Objektivave të Zhvillimit të Mijvjeçarit (*Millenium Development Goals* (MDG)) të Kombeve të Bashkuara.

rritja ekonomike përkthehet në më shumë vende pune dhe të ardhura kur norma e rritjes është mbi 6%.

Varfëria vazhdon të mbetet një fenomen shumë i përhapur në shoqërinë tonë dhe, në një kontekst të tillë, pabarazitë sociale bëhen edhe më shqetësuese. Sikurse duket dhe nga grafiku 10, gjatë dekadës së parë të tranzicionit, edhe pse u shënuan nivelet më të larta të rritjes ekonomike<sup>5</sup>, nivelet e varfërisë ishin tepër të larta, ku më shumë se 50% e popullsisë jetonin në **varfëri** (duke përdorur vijën e varfërisë së Bankës Botërore). Raporti vjetor i tranzicionit i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim i vitit 1999, që iu dedikua politikave të ekuitetit të tranzicionit, mënyrës se si u ndanë humbjet dhe përfitimet nga politikat transformuese të dekadës së parë, do të konkludonte: «*There can be no doubt that the transition has been associated with a heavy social burden on the people of many countries in the region*».<sup>6</sup> Shqetësimi mbi përhapjen e gjerë të varfërisë kërkonte trajtim me politika specifike, dhe Shqipëria, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe të FMN-së, hartoi një Strategji të Reduktimit të Varfërisë. U pa qartë se përpjekjet ishin të suksesshme, duke e reduktuar ndjeshëm nivelin alarmant të saj. Megjithatë, duket sikur treguesi i varfërisë është stabilizuar diku në fashën e 35%–40%, dhe për një periudhë të gjatë kohe rritja ekonomike nuk ka arritur të përkthehet në mirëqenie për më shumë qytetarë. Sipas vlerësimeve më të fundit të Bankës Botërore, varfëria në vitin 2018

Grafiku 9:

#### Rritja ekonomike dhe varfëria gjatë tranzicionit: 1993–2019



Burimi: Të dhënat e Bankës Botërore

Ajo që duket shqetësuese është se rënia e normave të rritjes ekonomike shoqërohet me rritje të varfërisë, siç shihet dhe në grafik. Kjo do të thotë se për të ruajtur objektivat e reduktimit të varfërisë, vendi duhet të arrijë norma të larta rritjeje. Sipas një studimi të Bankës Botërore mbi punësimin në vendet e rajonit të Ballkanit,

5 Duke përfshirë rënien me rreth 10% të PBB-së në vitin 1997 për shkak të trazirave sociale dhe konfliktit civil, për gjithë periudhën 1993–2000, rritja mesatare ekonomike vjetore ishte rreth 9.6%.

6 «Nuk ka dyshim se tranzicioni është shoqëruar me një barrë të madhe shoqërore për njerëzit e shumë vendeve të rajonit.»

u vërejt në 38.7% të popullsisë, ose 487 mijë qytetarë jetonin në varfëri. Goditjet e fundit negative ekonomike të shkaktuara nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe nga pandemia e COVID-19-s, kanë ndikuar në një shtim edhe më të madh të numrit të familjeve në prag të varfërisë. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, varfëria në Shqipëri mund të rritet në 44% të popullsisë në bazë vjetore, duke e shtuar numrin e personave në varfëri me 115–230 mijë individë.


Duke e përmbledhur këtë çështje, shkurtimisht mund të pohojmë se problemi i varfërisë në Shqipëri nuk është një çështje thjesht e perceptimit publik, por një fenomen me përhapje të gjerë dhe një shqetësim që vjen në rritje edhe për shkak të goditjeve serioze negative që ka marrë jeta ekonomike e sociale në vend gjatë dy viteve të fundit.

ekonomi, në kontekstin e një ekonomie në tranzicion, problemi i pabarazisë lidhet edhe me mënyrën e krijimit të pasurisë nëpërmjet reformave liberalizuese dhe privatizimit të pasurisë publike. Kjo është një nga temat shumë të debatuar, sidomos në dekadën e viteve '90, kur këto procese u vunë në zbatim, dhe perceptimi i publikut, i konfirmuar edhe nga pyetësorë, nënvizon se ky ka qenë një proces i padrejtë.

Veçanërisht **politikat e taksimit** dhe rregullat e kontabilitetit kanë mbështetur përqendrimin e pasurive dhe të aktiviteteve ekonomike dhe nuk kanë favorizuar investimet në përmirësim teknologjik dhe në kapitalin njerëzor brenda firmës. Për shembull, përjashtimi nga detyrimi i tatimit mbi fitimin në rast riinvestimi të fitimeve, që është zbatuar shpeshherë nga politikat tona

Grafiku 10:

### Përqindja e popullsisë në varfëri



Burimi: Të dhënat e Bankës Botërore

Prandaj, për të kuptuar nëse pabarazitë përbëjnë një kërcënim për sistemin, duhet hetuar më tej në **shkaqet e varfërisë dhe të pabarazive**.

Faktorët kryesorë të pabarazisë që thekson literatura akademike dhe që artikulojnë në debatin publik, si progresi teknologjik, globalizimi dhe ndryshimet demografike, nuk mund të ndahen nga faktorët specifikë të një vendi, të zgjedhjeve që qeveritë bëjnë lidhur me taksimin dhe programet e mirëqenies sociale<sup>7</sup>.

Përtej këtyre faktorëve tipikë që lidhen me pabarazitë në

fiskale, nuk është shoqëruar me kushtin që riinvestimi të kryhej brenda firmës dhe në aktivitete që lidhen me transferimin e teknologjive më të përparuara, të adoptimit të patentave dhe pasaportave teknologjike miqësore ndaj mjedisit, investimit të fuqia punëtore nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës, rritjes së pagave dhe shpërblimeve, trajnimit dhe kualifikimeve të personelit, zbatimit të mënyrave moderne të menaxhimit dhe të organizimit të prodhimit dhe sistemeve të tregtimit etj. Duke mos vendosur kushtëzime të tilla, firmat i kanë përdorur fitimet e patatuara për të shtënë në dorë biznese të tjera, me kosto shumë më të ulëta se konkurrentët e tyre.

<sup>7</sup> Atkinson, A B (1999): Is Rising Income Inequality Inevitable? A Critique of the Transatlantic Consensus, Third WIDER Annual lecture.

Në këtë mënyrë, edhe kredia bankare është përqendruar në pak biznese të mëdha, të cilat, nëpërmjet edhe favoreve të tilla, janë stimuluar të bëhen gjithnjë e më të mëdha. Po kjo lloj politike, ka favorizuar edhe përqendrimin e kredisë bankare. Duke rritur vlerën e tyre të kolateralit dhe duke disponuar likuiditet të mirë nga aktivitetet e tyre ekzistuese, këto biznese kanë tërhequr edhe më shumë kredi. Një përqendrim i tillë i shfaqti mangësitë e tij serioze kur problemi i kredive joperformuese u shndërrua në problemin më shqetësues për sistemin bankar në vitet 2010 e në vazhdim. Sipas informacioneve mediatike, përgjegjëse për gati 2/3 e totalit të kredisë me probleme ishin vetëm rreth 30 biznese private të mëdha.

Ky rast ilustron në mënyrë të dukshme se si rritja e pabarazive me anë të përqendrimin të pasurisë dhe të të ardhurave ndikon negativisht në sistemin financiar të një vendi dhe në rritjen ekonomike, e po kështu në nivelin mikroekonomik, në çmime më të larta për të mirat dhe shërbimet e ofruara, standarde më të ulëta të cilësisë dhe të rregullave të tjera të tregtimit.

Në mënyrë të ngjashme, edhe politikat e taksimit progresiv, të cilat pritet që teorikisht të ndikojnë në zbutjen e pabarazisë në shpërndarjen e së ardhurës kombëtare, në fakt, janë zbatuar vetëm për punëmarrësit, atë pjesë të popullatës që jeton me pagën nga puna. Ndërsa pjesa e popullsisë me të ardhura të larta (ose të pasurit, siç emërtohen në gjuhën popullore), në të vërtetë, e marrin të ardhurën vjetore të krijuar nga biznesi nëpërmjet dividendëve, fitimeve kapitale etj. Kështu, dividendi është e ardhura personale vjetore, pasi gjatë vitit, kjo kategori e popullsisë jeton me transfertat që kryhen nga veprimtaria normale e biznesit dhe që konsiderohen si shpenzime të veprimtarisë së firmës. Në fakt, dividendi trajtohet me një normë tatimore (8%) shumë më të favorshme se tatimi mbi të ardhurat nga paga, ku niveli maksimal i taksës marzhinale është 23%.

Studiues të shumtë (shih, për shembull, Piketty, Saez dhe Stantcheva, 2014)<sup>8</sup> kanë argumentuar se rënia e normave maksimale marzhinale të taksave shoqërohet me rritjen e të ardhurave që gjenerohen nga *top 1%*.

Por, thjesht **politikat e taksimit arrijnë të korrektojnë vetëm rezultatet finale** të ndarjes së të ardhurave, ato **nuk mund të trajtojnë korrektimin e proceseve që e gjenerojnë pabarazinë**. Çka do të thotë se, nëse korporatat kanë pozita dominuese në treg dhe rrjedhimisht mund të vendosin çmime më të larta nga sa do të ishin në kushtet e një tregu konkurrues, atëherë këto fitime të pamërituara do të çojnë në një përqendrim gjithnjë në rritje të pabarazive edhe në afat të gjatë. Për pasojë, duhet që **procesi ligjvënës të vendosë në një ekuilibër më të shëndetshëm përqendrimin e pushtetit dhe të tregut nga kapitali drejt punës**, që deri tani perceptohet gjerësisht si i anuar fort nga kapitali.

Një shqyrtim i thelluar i legjislacionit sektor për sektor, do të ishte një pikënisje e dobishme. Po kaq me rëndësi është edhe rishqyrtimi i raporteve debitor-kreditor, që deri tani mund të konsiderohen si gjerësisht në favor të kreditorëve, ose e thënë më qartë, në mbrojtje të bankierëve dhe në disfavor të industrisë.

Duke hetuar më tej **në shkaqet e varfërisë**, përveç problemeve që lidhen me rritjen përgjithësisht të dobët ekonomike dhe në rënie nga njëra dekadë në tjetrën, ajo është ngushtësisht e lidhur me nivelin e pagave. Ndonëse më e paktë për vendet e Ballkanit, literatura mbi lidhjet ndërmjet nivelit të pagave, pabarazisë dhe varfërisë është mjaft e pasur. Në një studim të FMN-së (2016)<sup>9</sup> mbi vendet e Ballkanit, nënvizohet se niveli i të ardhurave ka një efekt domethënës si në varfëri, dhe në pabarazi. Mund të nënkuptohet ndikimi i papunësisë në këtë marrëdhënie shkakësie, por kërkimi duhet përqendruar te dinamikat e pagave, si forma kryesore e të ardhurave të familjeve shqiptare, dhe fenomeni i varfërisë ndeshet gjerësisht edhe midis të punësuarve. Pra, varfëria dhe mungesa e të ardhurave nuk vijnë vetëm si pasojë e papunësisë, por dhe për arsye të cilësisë së punësimit. Në fund të vitit 2019, paga mesatare në ekonominë e Shqipërisë ishte rreth 30% më e ulët se paga mesatare më e ulët e rajonit – e Kosovës, dhe rreth 46% më e ulët se paga më e lartë në rajon – e Malit të Zi.

Kutiza 1:

#### Struktura e punësimit sipas nivelit të pagave

Zhvillimet në sektorin e pagave pas karantinës së parë tregojnë se përqendrimi në punonjësve me pagë të ulët ndaj totalit të të punësuarve me pagë është rritur.

Sipas të dhënave të INSTAT-it (2020), personat me pagë deri në 30 mijë lekë përbënin 38.7% të të punësuarve gjithsej në tremujorin e tretë të 2020-s, nga 37.1% në tremujorin e dytë.

Në të kundërt, kanë pësuar rënie grupet me paga të larta. Të dhënat tregojnë se grupi i të punësuarve me pagë nga 40 mijë deri në 50 mijë lekë përbën 11.4% të totalit të të punësuarve nga 11.7% të totalit në tremujorin e dytë.

Rënie e peshës në punësim u vu re edhe në grupet e tjera të pagave të larta. Të punësuarit me pagë 50 mijë deri në 60 mijë shënuan një rënie të peshës me 0.9 pikë përqindje, ata me pagë 60 mijë deri në 95 mijë shënuan rënie me 0.5 pikë përqindje dhe ata me paga mbi 120 mijë lekë zunë 4.5% të totalit të të punësuarve në tremujorin e tretë, nga 4.6% në tremujorin e dytë.

Të dhënat mbi pagat tregojnë modelin në të cilin po zhvillohet ekonomia shqiptare, ku gati 40% e të punësuarve marrin nivelin më të ulët të pagës, rreth 300 mijë lekë në muaj, ndërsa 26.8% e të punësuarve marrin vetëm pagën minimale prej 26 mijë lekësh në muaj.

Burimi: Revista "Monitor", 2020

Një nga pyetjet që mund të shtrohet në këtë rast është nëse pagat e ulëta reflektojnë nivelin e ulët të produktivitetit në ekonomi. Për këtë qëllim, ne kemi llogaritur rritjen mesatare vjetore të produktivitetit dhe të pagës mesatare sipas sektorëve të ekonomisë, bazuar në të dhënat e

8 Piketty, T., Saez, E. and Stantcheva, S. (2014): Optimal taxation of top labor incomes: a tale of three elasticities, American Economic Journal: Economic Policy, vol. 6, pp. 230–71, <https://doi.org/10.1257/pol.6.1.230>.

9 Zsoka Koczan, 2016, Being Poor, Feeling Poorer: Inequality, Poverty and Poverty Perceptions in the Western Balkans, IMF Working Paper WP/16/31.



Tabela 3:

**Paga mesatare mujore bruto sipas aktivitetit ekonomik, 2019 (euro)**

	Shqipëria	Maqedonia e Veriut	Mali i Zi	Serbia	Bosnja-H. (2018)	Kosova	Pay gap
<b>Gjithsej</b>	<b>420</b>	<b>617</b>	<b>773</b>	<b>699</b>	<b>689</b>	<b>602</b>	<b>(182)</b>
Bujqësi, silvikulturë dhe peshkim	295	497	854	586	632	346	(51)
Industri nxjerrëse	675	825	1,010	1,163	817	657	18
Industri përpunuese	291	528	599	631	499	340	(49)
Furnizimi me energji elektrike, gaz e avull...	614	968	1,299	1,154	1,094	923	(309)
Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizime...	316	526	719	583	667	451	(135)
Ndërtimi	338	578	667	672	452	493	(155)
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi automob.	324	580	569	595	491	353	(29)
Transport dhe magazinim	388	605	835	619	639	467	(79)
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	240	413	642	430	423	256	(16)
Informacioni dhe komunikacioni	640	1,159	1,105	1,219	1,021	797	(157)
Aktivitetet financiare dhe sigurimit	862	1,013	1,512	1,187	1,152	568	294
Pasuritë e patundshme	396	625	1,124	683	586	421	(25)
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	616	746	655	887	807	505	111
Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështet.	420	473	524	608	480	427	(7)
Administrimi publik dhe i mbrojtjes	536	712	910	826	981	606	(70)
Arsimi	506	650	746	712	717	488	18
Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	435	750	833	716	901	760	(325)
Art, argëtim dhe zbavitje	480	518	645	577	486	424	56
Aktivitete të tjera shërbimi	413	741	726	520	787	354	59
Shërbime në shtëpi	353	526		422			
Aktivitete të organizatave ndërkombëtare	1,220	903		713			

Burimi: Institucionet statistikore të vendeve përkatëse, përpunime të revistës "Monitor"

INSTAT-it. Produktiviteti në këtë rast është përcaktuar si raport i vlerës së shtuar që prodhon sektori me numrin e punëtorëve të atij sektori.

Të dhënat e tabelës 4 tregojnë për diferenca të rëndësishme ndërmjet rritjes së pagave dhe produktivitetit. Siç shihet, në shumë sektorë të ekonomisë mundësitë për një rritje më të fortë të pagave, të bazuar thjesht mbi rritjen e produktivitetit, janë plotësisht të motivuara. Fakti që produktiviteti ka pasur një rritje dukshëm më të lartë, do të thotë se përfitimet e ekonomisë nga rritja e produktivitetit kanë shkuar në favor të të ardhurave mbi kapitalin, ose të fitimit kapital.

Një pyetje shqetësuese që rezulton nga kjo analizë është **nëse ky nivel i lartë i varfërisë dhe i pabarazive sociale mund të përbëjë një kërcënim për stabilitetin e sistemit kapitalist, si dhe të vetë demokracisë**. Nuk është vetë pabarazia e pandershme, të tilla janë kryesisht proceset që e gjenerojnë atë.

Siç e treguan perceptimet e publikut, vetëm 2.5% e popullsisë besojnë se sistemi po funksionon mirë në

aspektin e shpërndarjes së të ardhurës kombëtare. Kjo ndoshta mund të mos përbënte kërcënim për sistemin nëse publiku sërish do të besonte se kjo pasuri është krijuar në mënyrë të merituar, se tregu ka shpërblyer riskmarrësit dhe individët që kanë investuar më shumë në rritjen e aftësive profesionale. Ky testim i opinionit publik tregoi se pothuajse gjysma e popullsisë (45%) e besojnë parimin e individualizmit dhe faktin se shoqëria funksionon më mirë kur individit mendon fillimisht për veten. Kjo do të thotë se, nëse sistemi funksionon sipas meritës, pabarazitë janë përgjithësisht të pranueshme nga shoqëria.

Por, nuk është ky rasti në Shqipëri: **pyetjes nëse të pasurit e kanë krijuar pasurinë me meritë, vetëm 8.8% i janë përgjigjur pozitivisht, më pak se 1 ndër 10 persona**.

Grupmoshat e ndryshme shfaqin qëndrime lehtësisht të ndryshme midis tyre. Kështu, grupmoshat e reja (18–24 vjeç) shfaqin më shumë tolerancë ndaj procesit të krijimit të pasurisë krahasuar me moshat mbi 60-vjeçare. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur pozitivisht 11% e kohortës së grupmoshës 18–24 vjeç dhe vetëm 5% e grupmoshës mbi 60 vjeç. Këto diferenca, të cilat duhet theksuar se janë të lehta pasi janë në numra shumë të vegjël, mund

Tabela 4:

**Rritja mesatare vjetore e produktivitetit dhe pagave për periudhën 2010–2018**

	Produktiviteti	Paga mesatare	Diferenca
1 Të gjithë prodhuesit për treg	7%	3%	- 4%
2 Industria nxjerrëse	11%	2%	- 8%
3 Ushqime, pije dhe duhan	8%	5%	- 3%
4 Tekstile dhe veshje	12%	4%	- 7%
5 Lëkurë dhe këpucë	12%	4%	- 8%
6 Druri, artik. me dru dhe mobilje	10%	5%	- 5%
7 Letra dhe shtypshkrimet	2%	3%	1%
8 Rafineria, Ind. kimike dhe plastike	36%	- 2%	- 38%
9 Produkte minerale jometalike	3%	1%	- 2%
10 Metalet dhe produkte metalike	8%	2%	- 6%
11 Ind. të tjera përpunuese	4%	2%	- 2%
12 Energjia elektrike dhe gazi	15%	3%	- 11%
13 Furnizimi me uje	21%	5%	- 17%
14 Ujërat e zeza dhe trajtimi i mbetjeve	11%	7%	- 4%
15 Ndërtimi	3%	1%	- 2%
16 Tregtia dhe riparimi automjet.	15%	3%	- 12%
17 Tregtia me shumicë	11%	3%	- 8%
18 Tregtia me pakicë	11%	7%	- 4%
19 Akomodimi	22%	5%	- 17%
20 Shërbimi ushqimor	7%	5%	- 2%
21 Transporti	4%	2%	- 2%
22 Posta dhe magazinimi	3%	3%	0%
23 Aktv. publikimeve dhe prodh. prog.	33%	3%	- 30%
24 Telekomunikacioni dhe transm. prog	3%	3%	1%
25 Shërbime të informacionit	- 70%	2%	72%
26 Aktivitete të pasurive të paluajtshme	10%	1%	- 9%
27 Shërbime profesionale	16%	5%	- 11%

Burimi: Autorët, llogaritur bazuar në të dhënat e INSTAT-it

t'u atribuohen edhe diferencave në mentalitetin e dy regjimeve të ndryshme në të cilat këto grupmosha kanë krijuar sistemet e vlerave dhe të besimeve të tyre.

Pavarësisht nga këto diferenca, konkluzioni në këtë rast është mjaft i qartë dhe i fortë: të bësh para pa sakrificë, pa mund dhe djersë, është diçka e gabuar, dhe **pabarazia në pasuri e krijuar në këtë mënyrë, është e padrejtë.**


Ky perceptim i publikut mbi pandershmërinë në krijimin e pasurisë sigurisht që e minon besimin e publikut te demokracia dhe ekonomia e tregut. Edhe sipas raportit të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), *Life in Transition* (2016), vetëm 50% e të intervistuarve në Shqipëri preferojnë demokracinë dhe ekonominë e tregut në raport me format e tjera të sistemeve politike

e shoqërore. Por, 31% e tyre mendojnë se një regjim autoritarist dhe një ekonomi e planifikuar do të ofronte zgjidhje më të mira për shoqërinë. Sipas këtij raporti, shqiptarët duken më pak mbështetës për demokracinë dhe ekonominë e tregut se vendet europiane, si për shembull, Gjermania.


Publiku e shikon shtetin më shumë si një instrument në duart e biznesit sesa si një aktor që ruan ndershmërisht balancën ndërmjet punës dhe kapitalit. Më shumë se 75% e të intervistuarve besojnë se **shteti anon më së shumti në favor të kapitalit.** Ky perceptim ndeshet njësoj midis gjithë kategorive të popullatës së intervistuar.

Siç u nënvizua gjerësisht edhe në analizat e mësipërme, politikat e pagave dhe të ndarjes së përfitimeve në

Grafiku 11:

**Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?**

Grafiku 12:

**Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi masat politike me ndikim në marrëdhëniet ekonomike dhe sociale në vend?**

ekonomi, politikat e taksimit dhe kapja e politikëbërjes nga grupe interesash, përhapja e gjerë e kontratave të partneritetit publik-privat në ofrimin e shërbimeve publike

sipas praktikave të dyshimta të prokurimit etj., janë faktorët kryesorë që kanë kontribuar në këtë perceptim shumë të anësuar të rolit të shtetit.

## 4

## INDIVIDUALIZMI DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Një grup pyetjesh të këtij studimi lidhen me perceptimet e shoqërisë mbi raportin midis individualizmit dhe solidaritetit social, një çështje me rëndësi në përzgjedhjen e modelit që shoqëria është e gatshme të përzgjedhë dhe të mbështetë. Një shoqëri që vlerëson më shumë individualizmin, sigurisht që do të kërkojë më pak ndërhyrje nga shteti dhe e kundërta. Në thelbin e vet, kjo përzgjedhje duhet parë në raportin midis forcave të tregut dhe rolit rregullator të shtetit në jetën ekonomike.

Gjithkujt mund t'i ndodhë të varfërohet në një situatë jashtë kontrollit. Ideja që qeveria duhet të ofrojë një rrjet sigurie është e hershme. Filozofi politik i shekullit XVII, Thomas Hobbes (1633/1651, f. 303-4), thekson: «Dhe ndërsa shumë individë, *rastësisht* bëhen të paafte të mbahen me punën që bëjnë, ata nuk duhen lënë në mëshirë të individëve, por duhen ndihmuar të përballojnë nevojat natyrore, sipas ligjeve të Republikës.» Teoria e rishpërndarjes si një mënyrë për të maksimizuar dobinë e përgjithshme të shoqërisë duke maksimizuar dobinë e individëve më të varfër, gjen përkrahje veçanërisht midis utilitaristëve dhe filozofëve të shquar, si John Rawls-i në librin e tij, *A Theory of Justice* (1971). Por edhe midis filozofëve libertarianë ka një rast kur ndërhyrja shtetërore në rishpërndarjen e së ardhurës është e pranueshme. Një argument i tillë silltet, për shembull, nga filozofi amerikan Robert Nozick në librin e tij, *Anarchy, State and Utopia*

(1974), i botuar si një kundërpërgjigje ndaj veprës së Rawls-it, por ku ai e pranon se, në rast se rezultoni se pasuria është vënë në mënyrë të pandershme, atëherë ka një mbështetje të fortë ideja e ndërhyrjes me politika të përshtatshme për të garantuar që vetë proceset e krijimit të pasurisë të jenë të ndershme. Në rastin e këtij studimi, ideja e ndërhyrjes së shtetit në rishpërndarjen e pasurisë gjen mbështetje sipas të dyja qasjeve ideologjike, pasi siç edhe e ndeshëm më herët, perceptimet e zbuluara nga publiku dëshmojnë se vetë procesi i krijimit të pasurisë ka qenë i padrejtë.

Shqipëria, me një trashëgimi totalitarizmi, ku shteti konsiderohej si një pjesë organike e shoqërisë dhe individit ekzistonte vetëm në kontekstin e shoqërisë dhe në shërbim të saj, realizoi një kapërcim të «ylberit» dhe brenda natës u rendit ndër shoqëritë që shtetin e shohin si një krijesë mekanike, të cilën individit e krijon me qëllim që të jetë në shërbim të vetë individit. Ky transformim në natyrën e sistemit, duhet të shoqërohej me një ndryshim të fortë kulturor të vlerave dhe besimit të individit. Por, siç e dëshmon ky raport, perceptimet e publikut, edhe pas tri dekadash tranzicioni, vijojnë të ruajnë fort qasjen sociale ndaj individualizmit. **Vetëm 1 ndër 5 persona beson se shoqëritë funksionojnë më mirë bazuar tek individualizmi**, çka dëshmon për një mosbesim të fortë të vetja dhe një rëndësi të lartë që merr shteti në

Grafiku 13:

**Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?**



sytë e publikut. Në një interpretim më të zbutur, duket se popullsia është e ndarë në mënyrë pothuaj simetrike: 45% e të intervistuarve anojnë nga individualizmi dhe 55% nga qasja sociale e shtetit.

Interesant është dallimi midis të rinjve, ku vetëm 17% e tyre janë përgjigjur se pajtohen plotësisht me një shoqëri të bazuar tek individualizmi, krahasuar me 27% të popullsisë mbi 60-vjeçare, një grupmoshë e formuar gjatë viteve të regjimit komunist, që pohojnë të njëjtën gjë. Në teorinë e financave publike, ky skepticizëm ndaj individualizmit midis grupmoshave të reja mund të shpjegohet me pasigurinë ndaj së ardhmes të të rinjtë dhe/ose shkallën e ulët të mobilitetit social. Megjithatë, diferencat ndërmjet grupmoshave zbuten kur rezultatet e intervistës agregojnë përgjigjet «pajtohem plotësisht» dhe «më shumë po».

Duke qenë një temë me interes në raport me politikën publike, veçanërisht të taksimit dhe shpenzimeve publike dhe rregullimin e funksionimit të tregjeve, po ndalemi më hollësisht në eksplorimin e faktorëve me natyrë ekonomike që mund të kenë ndikuar në ruajtjen e perceptimeve të tilla. Sigurisht që faktorët kulturorë, të trashëgimisë, kanë një rol parësor, por le të hetojmë pak më thellë në natyrën ekonomike të shkaqeve.

Shembja e sistemit komunist ushqe një program të fuqishëm reformash liberalizuese dhe protreg. Por kriza financiare e vitit 2008 krijoi një *momentum* të ri, duke nxitur një shqyrtim kritik të mënyrës së funksionimit të raportit treg-shtet.

Acemoglu (2009)<sup>10</sup> rendit tri kuptimet e gabuara intelektuale të mendimit ekonomik akademik të dekadës së fundit, të cilat shkurtimisht janë:

1. Besimi se kishte kaluar epoka e volatilitetit makro-ekonomik dhe se bota kishte hyrë në epokën që u quajt si «*Great Moderation*», një epokë ku ciklet e biznesit ishin bërë shumë të zbutura. Inovacioni financiar, duke e diversifikuar riskun e investimit në një mori aktorësh, kishte ushqyer zgjerimin në përmasa të mëdha të parasë dhe kreditit në ekonomi. Në këtë mënyrë, ndërsa kjo do të shërbente si një «policë sigurimi» për kompanitë dhe konsumatorët, njëkohësisht do të rritej ndërvarësia në të gjithë zinxhirin e aktorëve të sistemit, duke e bërë sistemin më «antifraxhil» ndaj goditjeve ekonomike. Çfarë ishte neglizhuar është fakti se sistemi ishte bërë shumë më i ekspozuar ndaj disa ndodhjeve me probabilitet të ulët, «*fat tails*», siç njihen në gjuhën teknike, për shkak se kjo ndërvarësi krijon potencial për efekte «domino» midis institucioneve financiare, kompanive dhe individëve.
2. Nocioni se ekonomia kapitaliste mund të jetojë në një vakuum institucional, ku thjesht tregjet janë edhe monitorueset e sjelljes së ekonomisë dhe vetëkorrigjimit, duke barazuar tregjet e lira me tregjet

e parregulluara. Një theks që u vu mbi rëndësinë dhe rolin e institucioneve menjëherë pas dekadës së parë të tranzicionit në ish-vendet komuniste, në fakt, kishte mbetur nën një perspektivë të kufizuar – se si mungesa e institucioneve kishte krijuar paradigmen se shtetet e varfra kishin mbetur të varfra, por jo në hulumtimin e natyrës së tyre, se si ato kishin shërbyer si gjeneruese dhe garantuese të prosperitetit në vendet e zhvilluara, dhe se si ato mund të evoluonin në kontekstin e evolimit të natyrës së marrëdhënieve ekonomike. Ajo që vlen të nënvizohet shkurtimisht është nevoja qartësisht e dukshme për të zhvilluar një teori të transaksioneve të tregut në sintoni me bazat e saj institucionale dhe rregullatore; një teori të re të rregullimit të firmës dhe tregjeve financiare.

3. U shemb nocioni sipas të cilit mund të besonim se korporatat e mëdha – «Lehman Brothers»-i, «Enron»-i, «Bear Sterns»-i,... – kishin akumuluar mjaftueshëm «kapital reputacional» sa të monitoronin vetveten. Krijua një besim të tepruar edhe se monitorimi i firmave të mëdha nga kompanitë e mëdha audituese («Andersen») ishte mjaftueshëm i besueshëm. Një valë shkrirjesh dhe bashkimesh (M&A), të cilat çuan në krijimin e një numri të paktë korporatash të fuqishme në fushën financiare, bëri që sistemi të ekspozohej së tepërmi ndaj risqeve dhe, falë pozicionit që krijon pranueshmëria e sindromës «*2B2 Fail*», e dobësoi akoma më shumë, deri në një shkallë të paprecedent, atë. Sistemi ekonomik krijoi incentiva që i nxitnin korporatat të kompromentonin integritetin dhe të sakrifikonin cilësinë e tyre. Ndëshkimi i tyre (lejimi i falimentimit) do të krijonte një vakuum të rrezikshëm për shoqërinë dhe do të ishte i papërbalueshëm edhe politikisht. Kjo gjendje krijon nevojën e një rishikimi të teorisë së kapitalit reputacional të firmës në kontekstin e teorisë së ekuilibrit të përgjithshëm.


Por, rritja e brishtësisë së sistemit bankar/financiar e ka bërë edhe më të brishtë sistemin ekonomik në tërësi, duke rrezikuar vetë thërmueshmërinë e sistemit. Krijesat «*2B2 Fail*» dhe «*2B2 Jail*» janë thellësisht të papajtuashme me konceptet e lirisë ekonomike dhe të transaksioneve për të cilat flasin mendimtarët libertarë, nga J.S.Mill-i dhe Smith-i deri te mbrojtësit e sotëm të neoliberalizmit.

Sistemi i tanishëm krijon kushte që disa individë të fuqishëm (bankierë, burokratë, akademikë, biznesmenë) të luajnë me të, ndërsa çmimin e kësaj loje e paguajnë qytetarët, siç e thotë Nassim Taleb-i (*Antifragility*), i cili vazhdon duke nënvizuar se «për të parën herë në histori, kaq shumë joriskmarrës, domethënë individë pa kurrfarë ekspozimi personal, ushtrojnë kaq shumë kontroll në shoqëri». Edhe Greenspan-i, i cili kishte mbrojtur teorinë e lirisë së tregjeve dhe eficiencën e mosrregullimit, më pas u detyrua të heqë dorë nga pozitat e veta, duke deklaruar: «Gabova duke presupozuar se organizatat, në mënyrë specifike bankat dhe të tjera të ngjashme me to, të shtyra nga interesi vetjak, do të ishin në gjendje të mbronin më mirë interesat e aksionerëve të vet.»<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Daron Acemoglu, 2009: The Crisis of 2008: Structural Lessons for and from Economics, MIT, 2009.

<sup>11</sup> Financial Times, October 2008: I Made a Mistake, Alan Greenspan

Grafiku 14:

**Sipas mendimit tuaj, sa aplikohet parimi i barazisë sociale aktualisht në Shqipëri?**

Nga ana tjetër, forcat e globalizimit dhe revolucioni teknologjik kanë krijuar nivele të reja ndërvarësie, ndërlidhjesh dhe kompleksitetesh, të cilat kanë potencialin e pazakontë që të destabilizojnë sistemin tonë tekno-socio-ekonomiko-mjedisor në një shkallë globale (Helbing, 2013)<sup>12</sup>. Prandaj është kritike gjetja e rrugëzgjidhjeve për të stabilizuar tregjet dhe rrjetet globale dhe për të kundërbalancuar këtë destabilitet sistemik.

Parimet e drejtësisë dhe të barazisë sociale që janë në themelet e ndërtimit të sistemit ekonomik dhe shoqëror, siç edhe e theksuam më sipër, në perceptimin e publikut

nuk janë një praktikë e ndeshur në rastin e Shqipërisë. Siç demonstron nga rezultatet e intervistave, vetëm 17% e popullatës besojnë se këto parime zbatohen në praktikë, ndërsa 37% mendojnë se këto parime nuk zbatohen aspak dhe 44.4% mendojnë se ato zbatohen deri diku.

Në konkluzion, mund të themi se shoqëria shqiptare beson se parimet e drejtësisë sociale nuk kanë gjetur zbatim në Shqipëri dhe se një sistem ekonomik e shoqëror funksionues duhet të mbajë në ekuidistancë raportet midis individit dhe shoqërisë.

<sup>12</sup> Dirk Helbing, Economics 2: The natural step towards a self-regulating, participatory market society, Discussion Paper, Evol.Inst. Econ.Rev. 10 (1): 2013.

# 5


## ROLI I SHTETIT PËRBALLË PASIGURIVE NË RITJE

Një grup pyetjesh i këtij studimi synonte të maste perceptimet që ka opinioni publik mbi rreziqet e sotme dhe të ardhme të shoqërisë dhe rolin e shtetit përballë pasigurish të tilla. Kjo vjen edhe në kontekstin e goditjeve

negative të marra gjatë dekadave të fundit, goditje që po bëhen me një frekuencë edhe më të shpeshtë, por edhe me kosto të mëdha e gjithnjë në rritje. Pa dyshim, shoqëria ku ne jetojmë është plot risqe dhe pasiguri.


Grafiku 15:

**Rreziku që njerëzit sot në Shqipëri të kenë rënie të mirëqenies sociale krahasuar me brezat e mëparshëm është:**



Grafiku 16:

**Rreziku për rënie të mirëqenies sociale të njerëzve në Shqipëri në të ardhmen do të:**



Goditjet e shpeshta negative që pëson ekonomia dhe frika nga humbja e vendit të punës dhe e të ardhurave, ashtu sikurse goditjet nga fatkeqësitë natyrore, të cilat janë asimetrike dhe me kosto shumë të larta, veçanërisht për grupet me të ardhura të ulëta, krijojnë një mjedis të karakterizuar nga pasiguri të shumta për të sotmen dhe të ardhmen.

Krahasuar me brezat e mëparshëm, perceptimi i publikut shqiptar mbi rreziqet e rënies në standardin e mirëqenies është dukshëm i lartë: 57% e popullatës janë përgjigjur se ky risk është «më i madh dhe shumë më i madh», ndërsa më shumë se 70% e tyre besojnë se rreziqet për brezin e ardhshëm do të vijnë në rritje.

Skepticizmi lidhur me të ardhmen dhe shtimin e gjasave të rënies së mirëqenies është veçanërisht i lartë te grupmoshat e reja dhe tek ata që sot janë në pikun e të ardhurave të tyre (grupmoshat 18–29 vjeç dhe 45–59 vjeç).

Parë në kontekstin e një sërë episodesh negative në shoqërinë tonë, që nga krizat ekonomike të shpeshta, fatkeqësitë natyrore që kanë goditur vendin (përmbajtje të njëpasnjëshme, tërmete) e deri te kriza aktuale serioze e shkaktuar nga pandemia e COVID-19-s, është i kuptueshëm ky skepticizëm i lartë ndaj së ardhmes.

Përballë këtij vlerësimi të lartë të risqeve të sotme dhe të ardhshme, cili do të ishte roli që mund të luajë shteti për të ndihmuar në zbutjen e pasigurive dhe krijimin e një mjedisi ekonomik e social që ofron më shumë mundësi për përparimin e standardeve të mirëqenies në familjet shqiptare?

Debati mbi rolin e shtetit në qasjen e vet historike, që nga Platoni e deri tek Adam Smith-i në epokën klasike, ka përvijuar dy pamje të kundërta: një pamje organike, ku shteti është pjesë esenciale e shoqërisë dhe ku individ i merr kuptim vetëm si pjesë e shoqërisë, dhe një pamje mekanike, ku shteti është një sajësë e njeriut, të cilën ai e ka ndërtuar që t'i shërbejë individit. Raportet midis shtetit dhe tregut të lirë kanë marrë ngjyrimë të ndryshme, ku herë pas here, në periudha të ndryshme, roli i njërit ndaj tjetrit është përforcuar ose është dobësuar. Për shembull, rënia e sistemit komunist në ish-vendet e Europës Qendrore dhe Lindore dhe në pjesët e tjera të botës, u shoqërua me një dominim të tregut të lirë ndaj shtetit, dhe ku vetërregullimi u shndërrua në doktrinën triumfuese. Por duket se krizat e herëpashërshme, veçanërisht pas krizës financiare të vitit 2008, e kanë ndryshuar raportin e forcave. Rirregullimi i tregjeve dhe një rol më aktiv i shtetit janë shndërruar në një doktrinë më të pranueshme, duke përfshirë dhe vendet simbol të kapitalizimit të bazuar mbi individualizmin, siç janë SHBA-ja dhe Britania e Madhe. Duke qenë se krizat shihen si shkaku kryesor që nxiti debatet aktuale mbi rolin e shtetit, do të ndalemi pak më hollësisht në diskutimet kryesore që po zhvillohen sot në mjediset akademike e intelektuale.

Krizat ekonomiko-financiare e sociale nuk janë një dukuri e re dhe as e panjohur. Duket sikur ato kanë qenë e do të jenë bashkudhëtarët e përhershme të zhvillimit dhe

kapitalizmit. Shqetësimi më i madh sot është: çfarë po ndodh me «recetat antikrizë»? Çfarë po bëjnë qeveritë për përballimin e krizave? Ekspertët vlerësojnë se aktualisht «recetat e vjetra historike antikrizë» po i nënshtrohen një analize dhe gjykimi më të gjerë. Diferencat në këto receta janë mjaft evidente dhe të pakrahasueshme me njëra-tjetrën.

Ndryshe nga doktrinat dhe mendimi dominues i viteve 1970–2000, të cilat, në kushtet e periudhave relativisht të qeta ekonomike e financiare, privilegjonin rolin dominues të tregut të lirë kundrejt një roli të reduktuar e minimal të shtetit në ekonomi, dy krizat e fundit: kriza financiare globale e vitit 2008 dhe veçanërisht kriza e shkaktuar nga pandemia e COVID-19-s, e kthyen vëmendjen në rolin e domosdoshëm të shtetit për përballimin dhe eliminimin e efekteve të tyre ekonomike e sociale. Kjo, sepse krizat e papritura dhe me shumë të panjohura e paqartësi për shkaqet dhe zhvillimin e tyre, rezervojnë shumë surpriza e të panjohura për ekonomistët, duke i detyruar ata të reflektojnë e t'i rimendojnë në thelb strategjitë, politikat ekonomike e masat specifike që duhen ndërmarrë në këto raste.

Në kushtet aktuale, **roli i Shtetit**, që aktualisht ndodhet në vijën e parë të luftës ndaj efekteve ekonomike e sociale të pandemisë së COVID-19-s, **nuk mund të mendohet si «një rol i zakonshëm i tij në kushte normale»**. Forca dhe rezistenca e goditjeve të tilla të paparashikuara dhe në shumë elemente të panjohura, kërkon që shteti të luajë një rol të ri më specifik: rolin e garantuesit të të ardhurave dhe shërbimeve shëndetësore në shkallë të gjerë. Ekonomisti Edmund Phelps, nobelisti në ekonomi në vitin 2006, për këtë situatë specifike përdor termin **«siguri dhe garanci sistemike»**, që nënkupton kalimin drejt një shoqërie që garanton një të ardhur minimale për gjithkënd, një tezë që do të kërkonte një riformatim edhe të rolit të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe një koordinim global të politikave sociale.

Pranimi i këtij roli të ri të Shtetit nga shoqëria në këtë situatë të jashtëzakonshme kërkon një qasje të re ndaj financimit të këtyre shpenzimeve, këndvështrime të reja për buxhetin, borxhin, sistemin fiskal, rolin e monedhës në kohë krize, mënyrat e sigurimit të këtyre financimeve nga ana e Shtetit etj.

Një nga aspektet dhe format e rëndësishme të rolit të Shtetit në ekonomi dhe ndërhyrjes aktive të tij është dhe **skema e pensioneve**. Skema e pensioneve në Shqipëri ndodhet aktualisht nën një presion negativ të dyfishtë nga plakja e popullsisë, çka nënkupton shtimin e numrit të personave që përfitojnë pension dhe pakësimin e kontribuesve në skemën e sigurimeve sociale. Kësaj i shtohet edhe informaliteti i lartë në tregun e punës, që nënkupton faktin se ka një numër të konsiderueshëm të punësuarish, të cilët, duke mos deklaruar punësimin, nuk kontribuojnë në skemën e sigurimeve sociale. Në Shqipëri përfitojnë pensione 621,2 mijë pensionistë dhe paguajnë kontribute 752,4 mijë kontribues. Norma e varësisë së sistemit është 1.22, që do të thotë se 122 kontribues mbulojnë 100 pensionistë. Të ardhurat e mbledhura



nga kontributet janë të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet për përfitime dhe, si rrjedhojë, diferenca mbulohet nga buxheti i shtetit. Nëse shohim peshën që zë financimi i buxhetit të shtetit në buxhetin total të ISSH-së, rezulton se në vazhdimësi, përtej disa luhatjeve afatshkurtra të ndikuara nga aksionet ndaj informalitetit apo ndryshimeve parametrike në skemën e pensioneve, kontributi nga buxheti i shtetit ka zënë mbi 40% të totalit të skemës së pensioneve. Kjo do të thotë se ajo nuk ka operuar asnjëherë si një skemë e bazuar në solidaritetin e brezave, por më shumë si një përgjegjësi sociale e financuar nëpërmjet të ardhurave tatimore. Kjo situatë ka bërë që fondi total i pensioneve të jetë i

kufizuar, duke u «përkthyer» në pensione tepër të ulëta për këtë kategori sociale. Pensionet mesatare mujore, urbane dhe rurale, të pensionistëve shqiptarë janë të ulëta dhe të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë të tyre. Mbi 90% e pensioneve janë ndjeshëm më të ulëta se paga minimale dhe minimumi jetik.

Kjo gjendje e ky shqetësim dëshmohej edhe nga anketa e zhvilluar, sipas së cilës 80% e të anketuarve mendojnë se «pensionet janë të pamjaftueshëm për të përballuar nevojat bazë», 15% janë «disi dakord», dhe vetëm 5% e tyre mendojnë se «pensionet janë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave bazë».


Tabela 5:

**Pensioni mesatar mujor 2015–2018 (në lekë)**

	2015	2016	2017	2018
<b>PENSIONE URBANE</b>				
Pension pleqërie	14,585	14,873	15,527	15,875
Pension invaliditeti	12,648	12,803	13,390	13,817
Pensione familjare	6,696	6,613	6,707	6,897
<b>PENSIONE RURALE</b>				
Pension pleqërie	8,330	8,556	8,808	8,792
Pension invaliditeti	6,501	6,595	6,451	6,630
Pensione familjare	3,240	2,830	2,478	2,312

Burimi: ISSH, Statistikat vjetore

Grafiku 17:

**Për sa i përket rolit të skemës së pensioneve, ju lutem jepni vlerësimin tuaj për pohimin e mëposhtëm:**


Përmirësimi i kësaj situatë lidhet ngushtë me një angazhim më të madh të Shtetit në reformimin e skemës së pensioneve, uljen e informalitetit në pagesën e kontributeve shoqërore dhe shtimin e financimeve nga buxheti i Shtetit për buxhetin e ISSH-së.


Çështje që presin trajtim dhe zgjidhje afatgjatë janë marrëdhëniet dhe opinionet e qytetarëve në lidhje me diversifikimin e skemave të pensioneve. Në vlerësimin e tyre për sa i përket pyetjes nëse «individit duhet të marrë më shumë përgjegjësi individuale për moshën e pensionit duke investuar dhe zbatuar skema të ndryshme investimi privat», rreth 70% e tyre kanë reaguar duke u shprehur se nuk janë «aspak dakord» ose janë «disi dakord», ndërsa vetëm 30% e tyre janë «dakord» dhe «shumë dakord» që të përfshihen në skema alternative, si pensionet

suplementare dhe pensionet private. Ky qëndrim ka të bëjë me tri elemente themelore: mendimin se skemën e pensioneve duhet të vazhdojë ta mbështetë buxheti i Shtetit dhe individët duhet të vazhdojnë të paguajnë vetëm detyrimet e sigurimit social sipas pagesave në fuqi aktualisht; mungesën e informacionit dhe të kulturës financiare për të njohur skemat alternative të pensionit; mungesën e besimit në qëndrueshmërinë dhe garancinë e këtyre skemave në realitetin shqiptar.

Roli i shtetit duket se merr rëndësi dhe në çështjet që njihen si detyra të qeverive, siç janë: mbrojtja e mjedisit dhe rreziqet e ndryshimeve klimatike, investimet më të forta në sektorët publikë, si arsimi, shëndetësia dhe infrastruktura, veçanërisht ajo hekurudhore, mbrojtja e vendeve të punës që rrezikohen për shkak të globalizimit tregtar etj.


Grafiku 18:

**Për sa i përket rolit të skemës së pensioneve, ju lutem jepni vlerësimin tuaj për pohimin e mëposhtëm:**



Grafiku 19:

**Shteti duhet: «të investojë më shumë para për mbrojtjen e klimës»**



Do të veçonim investimet në sektorin e arsimit dhe përmirësimin e cilësisë në arsim, si një element thelbësor që lidhet me zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe produktivitetin e ekonomisë. Shqipëria vijon të ketë financim të ulët për arsimin në raport me PBB-në, edhe kur krahasohet me vendet e tjera të rajonit. Historikisht, në Shqipëri shpenzimet e qeverisë për arsimin kanë qenë të ulëta, dhe gjatë 15 viteve të fundit mbetën kryesisht nën 3.5% të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB).

Në vitin 2007, një vit përpara krizës ekonomike financiare dhe recesionit ekonomik, shpenzimet për arsimin ranë në 3.2% dhe, pas krizës së vitit 2008, ato kanë qenë sistematikisht poshtë 3% të PBB-së. Në mënyrë krahasimore, në lidhje me shpenzimet në arsim si përqindje e PBB-së, treguesi i Shqipërisë është poshtë


vendeve të rajonit, që financojnë 4–5% të PBB-së për arsimin dhe poshtë vendeve të OECD-së, që financojnë 6–7% të PBB-së.

Financimi i pamjaftueshëm i arsimit ndikon negativisht në cilësinë e shkollimit, sidomos shtresat e varfra dhe ato të pavaforizuara të popullsisë. Me buxhetin e vënë në dispozicion, edhe gjatë vitit 2021, Shqipëria do të mbetet ndër vendet e fundit në Europë për investimet në arsim, duke mos arritur synimin e 5% të PBB-së.

Në lidhje me ndjeshmërinë dhe kërkesat e qytetarëve për strategjitë e zhvillimit dhe prioritetet që duhet të kenë investimet publike dhe orientimin e investimeve private, evidentohet fakti se një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve janë të ndërgjegjësuar për rëndësinë


Grafiku 20:

**Shteti duhet: «të investojë më shumë para për shkolla dhe universitete moderne»**




Grafiku 21:

**Shteti duhet: «të investojë më shumë para për një infrastrukturë më të mirë hekurudhore në vend»**



Grafiku 22:

**Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi masat politike me ndikim në marrëdhëniet ekonomike dhe sociale në vend?**

e **çështjeve dhe të problematikës së zhvillimit që lidhet me mjedisin dhe klimën**. 80% e të anketuarve shprehen pro faktit se «Shteti duhet të investojë më shumë para për mbrojtjen e klimës». Pozitiv është fakti se mbi 45% e atyre që shprehen pozitivisht në favor të rritjes së investimeve për mbrojtjen e klimës u përkasin grupmoshave të reja: 18–29 vjeç dhe 30–44 vjeç.

Konsensusi dhe qëndrimi i qartë duken më të plotë përballë pohimit nga 88% e të anketuarve se «**Shteti duhet të investojë më shumë para për shkolla dhe universitete moderne**», kundrejt vetëm 7.6% të tyre që mendojnë të kundërtën. Në Shqipëri mbizotëron qëndrimi dhe dëshira që Shteti duhet të investojë masivisht në rritjen dhe modernizimin e shkollave dhe universiteteve, pasi qytetarët gjykojnë se niveli aktual i tyre është i ulët dhe larg standardeve më të mira ndërkombëtare, duke ndikuar kështu në cilësinë e dobët të formimit të kapitalit human në vend. Në mjaft raste, si një ndër shkaqet e dëshirës për emigrim jashtë vendit, sidomos për brezat e rinj, është evidentuar edhe kërkesa «për një shkollim më cilësor në përfundim».

Interesant është qëndrimi dhe vlerësimi se «**Shteti duhet të investojë më shumë para për një infrastrukturë më të mirë hekurudhore në vend**». 82.6% e të anketuarve shprehen pro një kërkesë të tillë ndaj Shtetit. Ky qëndrim lidhet si me nostalgjinë e zhvillimit dhe të pozitës së hekurudhave shqiptare deri në vitet 1990, periudhë kur ato ishin një nga mjetet më të përdorura e më eficiente të transportit të njerëzve dhe mallrave, ashtu edhe me faktin se, për të pasur një infrastrukturë të zhvilluar në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe lidhjes me vendet e tjera të rajonit: Mali i Zi, Kosova,

Maqedonia e Veriut dhe Greqia, rrjeti hekurudhor modern dhe i plotë është domosdoshmëri. Një rrjet hekurudhor modern do të krijonte premisa pozitive për një shkallë më të madhe integrimi e bashkëpunimi me vendet e rajonit, do të favorizonte projekte e IHD të rëndësishme, do të lehtësonte qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në vend etj.

Në përfundim, perceptimet konsistente të të gjitha kategorive të popullsisë janë se roli i shtetit në modernizimin e shërbimeve publike dhe në funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore duhet të jetë aktiv dhe i drejtpërdrejtë. Sidoqoftë, mendojmë se është me rëndësi eksplorimi i formave të ndryshme të partneritetit edhe me sektorin privat, por kjo qasje kërkon një reformim të mënyrës së përzgjedhjes së projekteve, negocimit, kontraktimit dhe monitorimit të tyre. Gjithashtu, reformat e skemës së pensioneve duhen parë ngushtësisht në përputhje me zhvillimet në tregun e punës. Prirjet e zhvillimeve të ardhshme demografike nuk japin shpresa për përmirësime, përkundrazi, gjendja financiare e skemës së pensioneve do të përkeqësohet. Thjesht ndryshimet parametrike të sistemit do të jenë të paafta ta ndryshojnë gjendjen social-ekonomike të kësaj kategorie të popullsisë. Prandaj duhen menduar skema alternative në reformimin e të tria kolonave të sistemit, por edhe ndryshime sistematike të mundshme. Një alternativë mund të ishte vendosja e detyrimeve ligjore për fëmijët e punësuar, në formën e një pagese si kontribut për prindërit e moshuar në pension, e ngjashme me pensionin që paguhet për fëmijët në rastet e divorceve familjare. Sidoqoftë, një diskutim i thelluar mbi të ardhmen e skemës së pensioneve, mbështetur në një studim të plotë të alternativave të mundshme, duhet të vazhdojë.

## 6

## QASJA NDAJ PROCESIVE TË RAJONALIZIMIT DHE INTEGRIMIT

Shqipëria i përqafoi proceset globalizuese dhe integruese që me fillimet e tranzicionit, duke realizuar liberalizimin e plotë të aktivitetit të shkëmbimeve tregtare, si dhe të investimeve direkte e më vonë dhe atë të investimeve portofol. Ndërsa në fillim të viteve '90 këto zhvillime ishin të njëanshme, si nevojë e politikave të brendshme, pas viteve 2000, ato u diktuan nga proceset rajonalizuese dhe globalizuese ku Shqipëria filloi të aderojë.

Pas anëtarësimit në vitin 2000 në Organizatën Botërore të Tregtisë, nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin European në vitin 2006 dhe anëtarësimit në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me vendet e Europës Qendrore e Lindore (CEFTA) – që vinte


Sipas raportit të fundit të Organizatës Botërore të Tregtisë, rreth 49% e linjave tarifore<sup>13</sup> në Shqipëri importohen pa tarifa doganore. Tarifa doganore mesatare e thjeshtë është 4.2%, ndërsa për produktet bujqësore 8.7%.

Si rrjedhojë e politikave liberalizuese dhe rritjes ekonomike, aktiviteti i tregtisë me jashtë në vite është rritur ndjeshëm. Vetëm gjatë dekadës së fundit, 2008–2019, eksportet u rritën me 1.5 herë, ndërsa importet qenë rreth 36% më të larta.

Liberalizimi tregtar dhe reduktimi i ndjeshëm i barrierave tregtare tarifore, nxitën një proces të rëndësishëm rialokimesh të burimeve në ekonomi, duke krijuar grupe përfituesish

Grafiku 23:

### Tregtia e jashtme (milionë lekë)




pas nënshkrimit që nga viti 2001 në një rrjet bilateral të tregtisë së lirë me gjithë vendet e rajonit, duke përfshirë Moldavinë – po në këtë vit, Shqipëria e institucionalizoi pjesëmarrjen e saj në proceset globalizuese.


dhe humbësish. Sot globalizimi është shndërruar në një nga temat e forta të kundërshtuara nga opinioni publik botëror për shkak se ai është perceptuar se po funksionon vetëm për disa dhe jo për gjitha grupet shoqërore.

<sup>13</sup> Nga 9,386 linja tarifore, sipas Nomenklaturës së Kombinuar. WTO, Trade Policy Review, 2016.

Grafiku 24:

**Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi progresin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare?**

Grafiku 25:

**Procesi i integritit rajonal përgjithësisht ka sjellë:**

Ndikimet e tregtisë dhe të politikave tregtare në rritjen ekonomike dhe në varfëri<sup>14</sup> transmetohen nëpërmjet disa kanaleve, si: (i) çmimet dhe disponueshmëria e mallrave; (ii) çmimet e faktorëve, të ardhurat dhe punësimi; (iii) taksat dhe transfertat qeveritare; (iv) nxitjet për investime dhe inovacion; (v) goditjet e jashtme, veçanërisht nëpërmjet ndikimit në termat e tregtisë dhe (vi) risqet afatshkurtra dhe kostot e axhustimit (Winters, 2000<sup>15</sup>). Ky


diversitet i kanaleve të transmetimit e bën kuantifikimin e plotë të efekteve një sipërmarrje tepër komplekse, madje të pamundur. Një shqyrtim i hollësishëm i literaturës<sup>16</sup> lidhur me efektet e tregtisë dhe të politikave tregtare në varfëri, mund të gjendet në një studim të Hertel-it dhe Reimer-it (2004). Siç theksohet në këtë material, vlerësimet e efekteve të tregtisë dhe të politikave tregtare, përveçse dallojnë nga metodologjia (ekuilibri i përgjithshëm përkundërt ekuilibrit pjesor), nga baza e nisjes (për shembull, nga të dhënat e vrojuara të LSMS-së apo statistikave të llogarive kombëtare dhe mbi supozimet e bëra për sjelljen e një agjenti përfaqësues) etj., janë dhe të pjesshme, në kuptimin e vlerësimit të një apo dy kanaleve të transmetimit të efekteve të politikave.

<sup>14</sup> Vlerësimet e kësaj pjese datojnë deri në vitin 2005 pasi, në thelb, kjo është periudha më e fortë e liberalizimit tregtar të vendit. Në vitin 2001, Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe pjesë e rrejtës rajonal të tregtisë së lirë me vendet e rajonit, i cili përfundoi në vitin 2003 dhe u riformatua në kuadrin e CEFTA-s, në vitin 2006. Për pasojë, kjo është dhe periudha kur manifestohen efektet kryesore të proceseve të integritit ekonomik dhe tregtar.


<sup>15</sup> Winters, L. Alan, 2000: Trade, Trade Policy and Poverty: What are the links?, World Economy 25(9); 1339-67.

<sup>16</sup> Thomas W. Hertel and Jeffrey J. Reimer, 2004: Predicting the Poverty Impacts of the Trade Reform, World Bank Policy Research Working Paper 3444, November 2004.

Grafiku 26:

**Jepni vlerësimin tuaj për pohimin e mëposhtëm në lidhje me procesin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare:**

Grafiku 27:

**Jepni vlerësimin tuaj për pohimin e mëposhtëm në lidhje me procesin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare:**

Në rastin e Shqipërisë, një vlerësim i përgjithshëm ekonomik i proceseve integruese rajonale dhe europiane është realizuar nga Maliszewska dhe Kolesnichenko<sup>17</sup> (2004). Studimi konfirmon efektin e përgjithshëm pozitiv të proceseve integruese në mirëqenien e qytetarëve, si dhe vlerëson rialokimet sektoriale të burimeve ekonomike që pritet të ndodhin si pasojë e këtyre zhvillimeve. Një studim i ngjashëm është bërë dhe nga Xhepa (2005)<sup>18</sup>, duke përdorur modelin dhe bazën e të dhënave të

Projektit të Analizimit të Tregtisë Botërore (*Global Trade Analysis Project* (GTAP)), i cili gjithashtu zbulon se këto procese, edhe pse modeste, kanë një ndikim pozitiv në mirëqenie.

Duke përgjithësuar vlerësimet empirike të ndikimit të liberalizimit tregtar në mirëqenien e shoqërisë, mund të konkludojmë se ato kanë qenë më së shumti pozitive.

Ky konkluzion gjen mbështetje edhe nga perceptimet e publikut. Siç rezulton nga pyetësi, më shumë se 80% e popullatës besojnë se marrëveshjet e tregtisë së lirë me rajonin kanë qenë pozitive dhe ata e mbështetin thellimin e tyre. Gjithashtu shumica e qytetarëve besojnë se ato kanë sjellë avantazhe për ekonominë kombëtare.

<sup>17</sup> Maryla Maliszewska and Anna Kolesnichenko, 2004: General Equilibrium Analysis of Albania's Integration with the EU and South Eastern Europe, Center for Social and Economic Research, Warsaw, November 2004.

<sup>18</sup> Selami Xhepa, 2005: Free Trade with the Region, ACIT Papers.

Qytetarët janë disi të dyzuar mbi nevojën për një ruajtje të kontrollit mbi politikëbërjen dhe sovranitetin kombëtar në kontekstin e thellimit të procesit të globalizimit. Siç dëshmohet nga të dhënat e grafikëve në vijim, duket se në përgjithësi publiku nuk do të dëshironte të shihte heqjen dorë nga sovraniteti kombëtar si rezultat i thellimit të proceseve integruese, por nga ana tjetër, vërehet një nivel më i lartë besimi ndaj kontrollit të legjislacionit nga jashtë sesa nga politikanët vendas.

Një nga problemet kryesore të thellimit të integritimit me ekonominë botërore është se rritja e presioneve konkurruese çon në falimentime të industrive jokonkurruese dhe, për pasojë, në shtimin e papunësisë. Këtyre pasojave negative të globalizimit qeveritë u janë përgjigjur me projekte rikualifikimi të forcës së punës, në mënyrë që ajo të rialokohet drejt industrive të reja, që i rezistojnë konkurrencës së shtuar. Së dyti, një rrezik serioz për tregun e punës përbëjnë ndryshimet e rëndësishme teknologjike që kanë ardhur si pasojë e zhvillimit të

teknologjive të reja të njohura si Revolucioni i Katërt Industrial.

Ky rol që duhet të luajnë qeveritë gjen mbështetje edhe nga rezultatet e këtij pyetësi, ku rreth 80% e publikut besojnë se qeveritë duhet të luajnë një rol aktiv në mbrojtjen e vendeve të punës që rrezikohen nga globalizimi dhe digjitalizimi.

Në përfundim, mund të konkludojmë se opinioni publik i mbështet proceset e integritimit të vendit dhe dëshiron që ato të thellohen dhe më tej. Këto procese vlerësohen se kanë pasur avantazhe për ekonominë kombëtare dhe kanë ndikuar gjithashtu pozitivisht në mirëqenien e shoqërisë. Nga ana tjetër, publiku konsideron se qeveria duhet të luajë një rol më aktiv në mbajtjen nën kontroll të pasojave negative që ushtrojnë proceset e globalizimit dhe përparimit teknologjik mbi tregun e punës. Gjithashtu, kontrolli lokal mbi legjislacionin dhe ushtrimi i sovranitetit kombëtar vlerësohen me rëndësi nga publiku.



## 7

## VLERËSIME TË PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIME PËR POLITIKËBËRJEN

Ky studim i bazuar në matjen e perceptimeve të publikut, si dhe në vlerësimet empirike dhe teorike tregon se mënyra e funksionimit të sistemit ekonomik është shumë e anësuar. Rritja ekonomike gjatë tri dekadave të tranzicionit, edhe pse ka sjellë njëfarë progresi për shoqërinë në tërësi, ka rezultuar në prapambetje të grupeve të mëdha shoqërore. Ndarja e të ardhurave të krijuara nga kjo rritje ekonomike vlerësohet se ka favorizuar më shumë kapitalin dhe më pak punën, dhe rritja e produktivitetit në ekonomi mund të mbështetë nivele më të larta pagash. Si rrjedhojë, ndërhyrja e politikave publike për të garantuar një shpërndarje më të drejtë të të ardhurave është mjaft e motivuar. Nga ana tjetër, vetë procesi i krijimit të pasurisë konsiderohet si i padrejtë. Kjo do të thotë se jo vetëm rezultati i ndarjes së të ardhurave, por dhe procesi që e krijon atë, konsiderohet si shoqërisht i padrejtë. Kështu, ka dhe një argument më shumë për politika rishpërndarjeje, të cilat gjejnë mbështetje të gjerë nga të gjitha forcat e spektrove ideologjike të ndryshme. Korrektimi i sistemit kërkon reforma serioze për ndryshimin e qeverisjes ekonomike në shumë nivele dhe një rol aktiv të institucioneve publike.

Mbështetja sociale duhet konceptuar jo nëpërmjet paternalizmit, por nëpërmjet aftësimin të individit dhe pavarësimin të tij. Investimet dhe ndërhyrjet publike duhet të synojnë krijimin e shanseve të barabarta, duke shtuar veçanërisht investimet për edukimin dhe aftësimin profesional, veçanërisht të familjeve në nevojë. Nga ana tjetër, transferimi i pasurisë nga njëri brez në tjetrin nuk duhet të krijojë hendeqe të mëdha midis grupeve shoqërore që në njsje. Rritja e mobilitetit social duhet të jetë një objektiv me rëndësi për politikën publike.

Proceset e globalizimit dhe progresit teknologjik përbëjnë oportunitete me rëndësi, veçanërisht për ekonominë e vogla si Shqipëria. Ato mundësojnë aksesin në dijen dhe teknologjitë e reja në tregjet ndërkombëtare, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e produktivitetit të ekonomisë. Por në të njëjtën kohë ato paraqesin edhe rreziqe për tregun e punës. Kjo nënvizon dhe njëherë rëndësinë e rishqyrtimit të rolit të shtetit dhe të politikave më proaktive në krijimin dhe mbrojtjen e funksionimit të tregjeve.

Që ekonomia e nesërme të mos jetë një ekonomi e normave të ulëta të rritjes, e produktivitetit të ulët, e pabarazive

të larta dhe e një mjedisi të degraduar, duke lexuar me vëmendje mendimet e publikut dhe mësimet e nxjerra nga provat empirike, po paraqesim disa rekomandime që mund të ushqejnë politikëbërjen në vitet që vijnë:

### a. Politika për kontrollin e proceseve që prodhojnë pabarazi dhe rritje ekonomike jopërfshirëse:

- 1 Ndërmarrja e politikave financiare e fiskale të mirëstudiuara dhe afatgjata kërkojnë më së pari inovacione institucionale, siç mund të jetë themelimi i një **komiteti të politikave fiskale**, si një institucion i pavarur dhe profesional që garanton stabilitetin e financave publike. Ai do të vlerësojë programet buxhetore vjetore dhe 3-vjeçare të qeverisë, do të vlerësojë rreziqet fiskale për angazhimet e ndërmarrja nga kontrata të PPP-së ose forma të tjera koncesionesh, apo garancitë e ofruara për projekte të ndërmarrjeve publike dhe do të shqyrtojë çdo ndryshim të politikave fiskale dhe të sistemit tatimor në raport me pasojat që krjohen në ndarjen e të ardhurave kombëtare.
- 2 **Rregullat e kontabilitetit dhe të tatimit mbi veprimtarinë ekonomike** duhen rishqyrtuar me objektivin e ribalancimit më të mirë të shpërndarjes së të ardhurës kombëtare të krijuar. Në veçanti, favorizimet fiskale e tatimore që ofrohen herë pas here nga legjislacioni, duhet të kushtëzohen me rritjen e investimeve të firmave në përmirësimin e kapitalit fizik dhe atij njerëzor. Specifikisht, përmirësimi i kushteve të punës dhe rritja e të ardhurave të punëtorëve duhet të jenë një objektiv qendror i çdo përfitimi nga politikën publike apo lehtësie fiskale e financiare. Rishikimi duhet të përfshijë të gjithë legjislacionin për investimet e huaja strategjike dhe lehtësitë dhe privilegjet që ofrohen ndaj tyre, duke mos i kushtëzuar ato me nivelin e investimit, por me punësimin e mirë, kushtet dhe standardet e punës dhe të teknologjisë, sidomos kërkesat e ruajtjes së shëndetit në punë, efektet përhapëse të brendshme (nënkontraktimet dhe furnizimet e brendshme) etj.
- 3 **Rritja e transparencës së firmave dhe fuqizimi i rolit të audituesve**, bashkë me sistemin e ndëshkimeve në raste certifikimesh të bilanceve jokorrekte. Sistemi i përgjegjësisë për vërtetësinë e deklarimeve financiare

duhet të shihet në të gjitha hallkat, që nga punonjësi i autorizuar financiar i firmës, firmat që ofrojnë shërbimet e mbajtjes së llogarive dhe të hartimit të bilanceve, te procesi i certifikimit të audituesve dhe deri te roli i audituesit publik dhe i Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Nivelet shqetësuese të të ardhurave buxhetore përkundrejt një niveli tatimesh normative edhe më të larta se vendet e rajonit, janë dëshmi e shkallës së lartë të evazionit fiskal. Ky evazion ligjërohet nëpërmjet veprimtarisë së kontrollorëve dhe audituesve, duke sjellë pasoja serioze për ekonominë.

- 4 Pasuritë kombëtare të nëntokës dhe mbitokës dhe të gjitha marrëveshjet koncesionare të dhëna në ofrimin e shërbimeve publike, duhet të jenë subjekt i rregullave të veçanta kontabël dhe financiare. Megjithatë Shqipëria është anëtare e **Iniciativës së Transparencës së Industrive Ekstraktuese (ITIE)**, e cila dikton plotësimin e **standardeve të caktuara të transparencës dhe raportimit financiar**, fatkeqësisht nuk disponohet asnjë dokument zyrtar nëse vendi i ka plotësuar detyrimet e kësaj marrëveshjeje. Duhet që institucionet shtetërore, ministrinë të përkatëse t'i detyrojnë firmat të plotësojnë çdo detyrim që buron nga këto rregulla, duke i adaptuar ato si rregulla të brendshme ligjore dhe jo si detyrime që thjesht vijnë nga ITIE-ja dhe duken sikur janë fakultative. Propozojmë që rregulla të posaçme të transparencës dhe raportimit financiar të shtrihen jo vetëm te firmat që merren me shfrytëzimin e pasurive të nëntokës, por te të gjitha marrëveshjet koncesionare që u japin subjekteve private një të drejtë përdorimi të aseteve publike.
- 5 Investimi për **edukimin e të rinjve dhe integrimin e tyre në tregun e punës** është një nga prioritetet më absolute për shoqërinë. Sot ka më shumë se 250 mijë të rinj që nuk ndodhen as në bankat e shkollave, as në marrëdhënie pune. Kualifikimi i tyre me aftësi profesionale dhe integrimi në tregun e punës janë sfida serioze, porë dhe në kontekstin e një ekonomie të bazuar në standarde më të larta teknike e teknologjike. Gjithashtu, mbyllja për shkak të pandemisë së COVID-19-s ka ndikuar në cilësinë e edukimit dhe aftësimin e studentëve, që me gjasa do të lënë gjurmë afatgjata duke ndikuar në të ardhurat e tyre. Forcat politike duhet të ndërmarrin masa kurajoze për financimin e arsimit ose nëpërmjet skemës së taksimit të përgjithshëm, që do të thotë të rikonsiderojnë sistemin tatimor për rritjen e ndjeshme të të ardhurave të buxhetit, ose nëpërmjet tarifave më të larta dhe subvencioneve reale për studentët nga shtresat në nevojë. Nga ana tjetër, indikatorët e cilësisë së sistemit arsimor dhe treguesit e performancës së çdo institucioni arsimor duhet të fillojnë të zbatohen për përfitim dhe financime publike nga institucionet publike të arsimit.
- 6 **Impaktet e ndryshimeve teknologjike** të stimuluarat së tepërmi në kushtet e pandemisë së COVID-19-s dhe të perspektivave akoma më të gjera në të ardhmen e afërt në këtë drejtim, duhet të mbahen në konsideratë nga politikat e qeverisë. Rrezikimet e vendeve të punës për shkak të progresit teknologjik kërkojnë një

vëmendje të shtuar, dhe politikat publike që mbështetin transferime teknologjike dhe inovacione, duhet të favorizojnë punësueshmërinë e dimensionin human të teknologjisë (për shembull, politikat e subvencioneve).

- 7 Roli i sindikatave të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë duhet të jetë shumë më aktiv, me synim përmirësimin e dialogut social, artikullimit publik dhe mbrojtjen e interesave të punonjësve.
- 8 Është e domosdoshme një strategji më aktive për identifikimin dhe hartimin e politikave të duhura nxitëse të punësimit dhe formimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen vende pune cilësore që garantojnë të ardhura sa më të larta për punonjësit, mundësi për aftësim gjatë gjithë ciklit të jetës, si dhe përmirësimin rrënjësor të sistemit të shërbimeve të punësimit dhe arsimit profesional.
- 9 Shndërrimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë aktive riintegrimi nëpërmjet krijimit të paketave e masave specifike për krijimin dhe rritjen e mundësive për punësim, duke shtuar përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës të përfutësve të Ndhmës Ekonomike.
- 10 Rritja e eficiencës së skemës së Ndhmës Ekonomike dhe transformimi i saj nga një skemë pasive në një skemë aktive me ndihmën e programeve të riintegritimit dhe kombinimit të tyre me skemat e punësimit nëpërmjet krijimit të lidhjes së qëndrueshme midis skemës së Ndhmës Ekonomike dhe skemave të arsimit profesional dhe programeve të përgatitjes për punësim, me synim fuqizimin dhe aktivizimin e familjes dhe individit në tregun e punës.
- 11 Në kuadrin e strategjisë dhe politikave të mbrojtjes sociale është e nevojshme që objektivat të jenë sa më të qartë, të mirëadresuar dhe të matshëm, me synim kryesor reduktimin e varfërisë dhe të ekspozimit të familjeve të varfra e grupeve sociale të pambrojtura ndaj rreziqeve dhe goditjeve të natyrave të ndryshme që ndikojnë në nivelin e varfërisë, duke fuqizuar aftësinë e tyre për t'u mbrojtur nga rreziqet, për të shmangur mungesën e të ardhurave, si dhe për të mbajtur një standard jetese të pranueshëm.

## **b. Politika për korrektimin e rezultateve që krijohen nga shpërndarja ekonomike:**

- 12 Me qëllim që të krijohen kushte më të barabarta në oportunitetet ekonomike që në nisje, në kushtet e nevojës për një harmonizim e balancim më të mirë në ngarkesën fiskale ndërmjet taksimit të punës, kapitalit dhe pronës, Shqipëria duhet të shqyrtojë me prioritet **vendosjen e tatimit mbi trashëgiminë**. Në të gjitha vendet taksa e trashëgimisë është një politikë e rëndësishme publike jo vetëm thjesht për qëllime fiskale, por me qëllime më madhore të rishpërndarjes së të ardhurës së krijuar ndër breza dhe të zbutjes së diferencave midis brezave në fillimin e veprimtarisë profesionale të tyre. Praktikrat që zbatohen janë të njohura: (a) vendosja e një vlere të caktuar si prag përjashtimor për trashëgiminë te fëmijët

dhe e një norme tatimi mbi vlerën e pronës/pasurisë së trashëguar (relativisht të lartë – deri në 40% nga vende të tilla, si Britania e Madhe, SHBA-ja etj.); ose (b) vendosja e normave më të ulëta dhe me përjashtime shumë të kufizuara (kryesisht dhe vetëm brenda familjes së ngushtë).

13 Progresiviteti tatimor nuk duhet të zbatohet vetëm mbi të ardhurat personale të të punësuarve. Ky parim duhet të shtrihet edhe mbi të ardhurat që shpërndan biznesi në formën e dividendëve. Dividendi është e ardhura personale e atyre që mund të konsiderohen si shtresa e pasur e shoqërisë, dhe mosshtrirja e parimit të progresivitetit të kjo kategori e shoqërisë do të ishte një padrejtësi shoqërore. Nga ana tjetër, zbatimi i një norme të reduktuar tatimore (8%) ndërkohë që norma marzhinale tatimore për të punësuarit me paga të larta është 23%, ndihmon edhe në përqendrimin e pasurisë nëpërmjet procesit të akumulimit, duke rritur gjithnjë e më shumë pabarazinë sociale.

14 Kuadri ligjor i qeverisjes së firmës duhet të rishqyrtohet për të ribalancuar pushtetin midis aktorëve brenda saj: punëmarrës dhe punëdhënës. Një mori ligjesh që janë nxjerrë në mbrojtje të interesave të punëmarrësve, nuk kanë gjetur aspak zbatim, duke konfirmuar se ato janë adoptuar thjesht në kuadër të respektimit të detyrimeve ndërkombëtare, siç janë ato që burojnë nga procesi i integritimit evropian. Është e nevojshme të nisë një diskutim i madh brenda vendit lidhur me raportet mes

punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe me përzgjedhjen e **instrumenteve më efikase detyruese për ruajtjen e një balance më të mirë të interesave të palëve**. Inspektoratet shtetërore që përgjigjen për monitorimin e respektimit të këtyre standardeve duhet të hartojnë raporte vjetore të punës së tyre dhe këto të fundit duhet të bëhen transparente për publikun. Mund të konsiderohet edhe pajisja me një **certifikatë cilësie e firmave që respektojnë standardet e punëtorëve dhe të mjedisit**, si një mënyrë për të nxitur gjithashtu mbështetjen apo ndëshkimin e publikut ndaj produkteve dhe shërbimeve të firmave.

15 **Legjislacioni mbi pagën minimale** në ekonomi duhet të forcohet. Duhet të kontrollohet rigorozisht nga institucionet ligjzbatuese zbatimi i tij dhe masat ndëshkuese në rast zbulimi të shkeljeve duhen ashpërsuar ndjeshëm. Mund të hartohet dhe një **kod i praktikave për pagesat mbi pagën minimale** bazuar në një dialog kombëtar në Këshillin Trepalësh: punëdhënës-punëmarrës-qeveri.

16 Është e domosdoshme të përcaktohet niveli real i varfërisë dhe minimumit jetik në vend, analizuar sipas nivelit të çmimeve, shportës së konsumit, nivelit të shpenzimeve dhe nivelit të inflacionit, ndikimit të situatës së pandemisë së COVID-19-s në thellimin e varfërisë etj., me qëllim që të vlerësohet drejt kontributi në reduktimin e varfërisë dhe të ruhet transparencja mbi shpenzimin e fondeve publike për reduktimin e saj.

## REFERENCA

**Acemoglu, Daron** (2009): *The Crisis of 2008: Structural Lessons for and from Economics*, MIT.

**Atkinson, A B** (1997): *Bringing Income Distribution in from the Cold*, *Economic Journal* 107: 297-321.  
(1999): *Is Rising Income Inequality Inevitable? A Critique of the Transatlantic Consensus*, Third WIDER Annual Lecture.

**Case, Anne and Deaton, Angus** (2020): *Deaths of Despair and the Future of Capitalism*, Princeton University Press.

**EBRD** (2016): *Life in Transition*.

**Financial Times** (October 2008): *I Made a Mistake*, Alain Greenspan.

**Helbing, Dirk** (2013): *Economics 2: The natural step towards a self-regulating, participatory market society*, Discussion Paper, *Evol.Inst.Econ.Rev.* 10 (1).

**Hertel, Thomas W. and Reimer, Jeffrey J.** (2004): *Predicting the Poverty Impacts of the Trade Reform*, World Bank Policy Research Working Paper 3444, November 2004.

**Institute for Fiscal Studies** (May 2019): *Inequalities in the 21st century*.

**Koczan, Zsoka** (2016): *Being Poor, Feeling Poorer: Inequality, Poverty and Poverty Perceptions in the Western Balkans*, IMF Working Paper WP/16/31.

**Maliszewska, Maryla dhe Kolesnichenko, Anna** (2004): *General Equilibrium Analysis of Albania's Integration with the EU and South Eastern Europe*, Center for Social and Economic Research, Warsaw, November 2004.

**Nozick, Robert** (1974): *Anarchy, State and Utopia*.

**Piketty, T., Saez, E. and Stantcheva, S.** (2014): *Optimal taxation of top labor incomes: a tale of three elasticities*, *American Economic Journal: Economic Policy*, vol. 6, pp. 230–71, <https://doi.org/10.1257/pol.6.1.230>.

**Rawls, John** (1971): *A Theory of Justice*.

**Xhepa, Selami** (2005): *Free Trade with the Region*, ACIT Papers.

**Winters, L. Alan** (2000): *Trade, Trade Policy and Poverty: What are the links?*, *World Economy* 25(9); 1339-67.

**WTO** (2016): *Trade Policy Review*.

## ANEKSI 1: PYETËSORI

**1. Sa pajtoheni me pohimet mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?**

- a) Shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave dhe pasurisë në Shqipëri po bëhet gjithnjë e më shumë një problem për kohezionin social në popullatë.
- b) Në Shqipëri, kur ekonomia është në gjendje të stabilizuar, prej saj zakonisht përfitojnë të gjithë qytetarët.
- c) Qytetarët shqiptarë që renditen ndër më të pasurit, pra, ata që fitojnë shumë dhe zotërojnë pasuri, zakonisht, e kanë merituar këtë pasuri.
- d) Një shoqëri funksionon në mënyrën më të mirë kur secili mendon fillimisht për veten.

	Pajtohem plotësisht
	Më shumë po
	Më shumë jo
	Nuk pajtohem

**2. Për sa i përket rolit të skemës së pensioneve, ju lutem jepni vlerësimin tuaj për pohimet e mëposhtme:**

- a) a mendoni se pensioni është i mjaftueshëm për të përballuar nevojat bazë?
- b) a do të ishit i/e mendimit që individi duhet të marrë më shumë përgjegjësi individuale për moshën e pensionit duke investuar dhe zbatuar skema të ndryshme investimi privat? (p.sh.: llogari kursimi për pension të garantuara dhe pa tatime; skema fondesh private pensioni etj.)

	Aspak dakord
	Disi dakord
	Dakord
	Shumë dakord

**3. Sipas mendimit tuaj, sa zbatohet parimi i barazisë sociale aktualisht në Shqipëri?**

	Aspak
	Deri diku
	Zbatohet
	Zbatohet masivisht
	Nuk e di

**4. Sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme mbi masat politike me ndikim në marrëdhëniet ekonomike dhe sociale në vend?**

- a) Në politikë u kushtohet shumë vëmendje interesave të sektorit privat dhe pak vëmendje interesave të popullatës.
- b) Qeveria duhet t'i mbrojë më shumë njerëzit nëse atyre iu rrezikohet në masë vendi i punës si pasojë e digjitalizimit ose globalizimit.

	Aspak dakord
	Më shumë jo
	Më shumë po
	Plotësisht dakord
	Aspak dakord

**5. Rreziku që njerëzit sot në Shqipëri të kenë rënie të mirëqenies sociale krahasuar me brezat e mëparshëm është:**

	Nuk ekziston
	Shumë më i vogël
	Më i madh
	Shumë më i madh
	Nuk e di

**6. Rreziku për rënie të mirëqenies sociale të njerëzve në Shqipëri në të ardhmen do të:**

	Rritet shumë
	Me gjasa do të rritet
	Me gjasa do të ulet dhe/ose do të ulet

**7. Shteti duhet:**

- a) të investojë më shumë para për mbrojtjen e klimës;
- b) të investojë më shumë para për shkolla dhe universitete moderne;
- c) të investojë më shumë para për një infrastrukturë më të mirë hekurudhore në vend.

	Po
	Jo
	Nuk e di

**8. Sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme mbi progresin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare?**

- a) Marrëveshjet e tregtisë me rajonin kanë qenë shumë produktive dhe duhen thelluar me tej.

- b) Marrëveshjet ekonomike që synojnë afrimin e procesit të integritit në BE kanë pasur/kanë një ndikim shumë pozitiv për Shqipërinë.

	Plotësisht
	Me shumë po
	Me shumë jo
	Aspak
	Po
	Jo

**9. Jepni vlerësimin tuaj për pohimet e mëposhtme në lidhje me procesin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare:**

- a) Politikanët e zgjedhur duhet të kenë sërish më shumë ndikim në legjislacionin kombëtar dhe të mundën të vendosin rregulla të vlefshme.

- b) Procesi i integritit ekonomik dhe financiar në rajon duhet të thellohet më tej, edhe nëse kjo nënkupton heqjen dorë deri diku nga sovraniteti kombëtar.


	Aspak dakord
	Disi dakord
	Dakord
	Plotësisht dakord

**10. Procesi i integritit rajonal përgjithësisht ka sjellë:**

	Më shumë avantazhe
	Më shumë disavantazhe
	Nuk e di


## ANEKSI 2: PËRGJIGJET E PËRMBLEDHURA TË PYETËSORIT

### 1.a Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 66.60% të totalit, pajtohen plotësisht me pohimin se shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave dhe pasurisë në Shqipëri po bëhet gjithnjë e më shumë një problem për kohezionin social në popullatë.

### 1.b Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?




Nga të dhënat e mësipërme, rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 56.4% të totalit, shprehin "më shumë po" dhe pajtohen plotësisht me pohimin se në Shqipëri, kur ekonomia është në gjendje të stabilizuar, prej saj zakonisht përfitojnë të gjithë qytetarët.

1.c Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?



Nga të dhënat e mësipërme, rezultojnë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 75% të totalit, nuk pajtohen ose shprehin “më shumë jo” për pohimin se qytetarët shqiptarë që renditen ndër më të pasurit, pra, ata që fitojnë shumë dhe zotërojnë pasuri, zakonisht, e kanë merituar këtë pasuri.


1.d Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi marrëdhëniet ekonomike dhe sociale aktuale në Shqipëri?



Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 29.7% të totalit, nuk pajtohen me pohimin se një shoqëri funksionon në mënyrën më të mirë kur secili mendon fillimisht për veten.




2.b Për sa i përket rolit të skemës së pensioneve, ju lutem jepni vlerësimin tuaj për pohimin e mëposhtëm:




Nga të dhënat e mësipërme, na rezulton si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 30% të totalit, nuk janë aspak dakord me pohimin se individi duhet të marrë më shumë përgjegjësi individuale për moshën e pensionit duke investuar dhe zbatuar skema të ndryshme investimi privat.

3. Sipas mendimit tuaj, sa aplikohet parimi i barazisë sociale aktualisht në Shqipëri?




Nga të dhënat e mësipërme, duket se shumica e të intervistuarve besojnë se aktualisht në Shqipëri nuk zbatohet parimi i barazisë sociale.

4.a Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi masat politike me ndikim në marrëdhëniet ekonomike dhe sociale në vend?




Nga të dhënat e mësipërme, rezultojnë se shumica e të anketuarve besojnë se në politikë u kushtohet shumë vëmendje interesave të sektorit privat dhe pak vëmendje interesave të popullatës.

4.b Sa pajtoheni me pohimin e mëposhtëm mbi masat politike me ndikim në marrëdhëniet ekonomike dhe sociale në vend?




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 44.40% të totalit, janë përgjigjur "plotësisht dakord" për sa i përket pohimit se qeveria duhet t'i mbrojë më shumë njerëzit nëse atyre i rrezikohet në masë vendi i punës si pasojë e digjitalizimit ose globalizimit.

5. Rreziku që njerëzit sot në Shqipëri të kenë rënie të mirëqenies sociale krahasuar me brezat e mëparshëm është:




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 37.50% të totalit, janë përgjigjur se, krahasuar me brezat e mëparshëm, ka rrezik më të madh që njerëzit sot të kenë rënie të mirëqenies sociale.

6. Rreziku për rënie të mirëqenies sociale të njerëzve në Shqipëri në të ardhmen do të:




Rreziku për rënie të mirëqenies sociale të njerëzve në Shqipëri në të ardhmen ka gjasa të rritet.

7.a Shteti duhet të investojë më shumë para për mbrojtjen e klimës:




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 81.80% të totalit, janë përgjigjur “po” për sa i përket pyetjes se shteti duhet të investojë më shumë para për mbrojtjen e klimës.

7.b Shteti duhet të investojë më shumë para për shkolla dhe universitete moderne:




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 88.00% të totalit, janë përgjigjur “po” për sa i përket pyetjes se shteti duhet të investojë më shumë para për shkolla dhe universitete moderne.

7.c Shteti duhet të investojë më shumë para për një infrastrukturë më të mirë hekurudhore në vend:




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 82.60% të totalit, janë përgjigjur "po" për sa i përket pyetjes se shteti duhet të investojë më shumë para për një infrastrukturë më të mirë hekurudhore në vend.

8.a Sa pajtoheni me pohimin mbi progresin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare?




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 47.10% të totalit, janë përgjigjur "më shumë po" për sa i përket pohimit se marrëveshjet e tregtisë me rajonin kanë qenë shumë produktive dhe duhen thelluar më tej.

8.b Sa pajtoheni me pohimin mbi progresin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare?




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 45.40% të totalit, janë përgjigjur “më shumë po” për sa i përket pohimit se marrëveshjet ekonomike që synojnë afrimin e procesit të integritit në BE kanë pasur/kanë një ndikim shumë pozitiv për Shqipërinë.

9.a Jepni vlerësimin tuaj për pohimin e mëposhtëm në lidhje me procesin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare:




Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 37.20% të totalit, janë përgjigjur “disi dakord” për sa i përket pohimit se politikanët e zgjedhur duhet të kenë sërish më shumë ndikim në legjislacionin kombëtar dhe të mundin të vendosin rregulla të vlefshme.

9.b Jepni vlerësimin tuaj për pohimin e mëposhtëm në lidhje me procesin e integritit rajonal në fushën ekonomike dhe financiare:



Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 38.50% të totalit, janë përgjigjur “aspak dakord” për sa i përket pohimit se procesi i integritit ekonomik dhe financiar në rajon duhet të thellohet më tej, edhe nëse kjo nënkupton heqjen dorë deri diku nga sovraniteti kombëtar.

10. Procesi i integritit rajonal përgjithësisht ka sjellë:



Nga të dhënat e mësipërme, na rezultojnë si gjetje se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 64.50% të totalit, janë përgjigjur “më shumë avantazhe” për sa u përket efekteve të procesit të integritit.





## MBI AUTORËT

### **Prof.As.Dr. Selami Xhepa**

Mban titullin “Profesor i Asociuar” në shkencat ekonomike dhe është lektor në Universitetin Europian të Tiranës. Përveç karrierës akademike dhe angazhimit profesional në disa institucione të ndryshme, duke përfshirë detyrën si Kryeekonomist në Departamentin e Kërkimeve dhe Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë dhe Drejtues Kërkimesh në Qendrën për Tregtinë Ndërkombëtare, Dr. Xhepa ka mbajtur dhe poste administrative. Ai ka shërbyer si Drejtues Ekzekutiv i Agjencisë së Investimeve të Huaja, Këshilltar për politikat ekonomike pranë Kryeministrit dhe anëtar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë. Interesat kërkimorë përfshijnë fushat e ekonomisë ndërkombëtare dhe të zhvillimit.

### **Akademik i Asociuar, Prof.Dr. Adrian Civici**

Doktor në shkencat ekonomike (ENSA, Montpellier, Francë, 2002) dhe doktor në Ekonomi Agrare (Universiteti Bujqësor i Tiranës, 1993). Në 1995 merr titullin “Profesor i Asociuar” dhe nga viti 2011, mban titullin “Profesor” në shkencat ekonomike. Gjatë karrierës profesionale ka punuar si: Përgjegjës i Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave Agrare, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë Agrare në UBT; Drejtor Ekzekutiv i Qendrës së Studimeve Rurale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm; Këshilltar i Ministrisë të Financave; Drejtor i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Shqipërisë; Këshilltar për Planin Zhvillimor pranë Qeverisë së Kosovës; Rektor i UET, Zv/Rektor dhe Drejtor i Shkollës Doktorale në UET; Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; President i UET dhe Dekan i Fakultetit të Ekonomisë në UMSH. Aktualisht Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Fushat e ekspertizës: politikat ekonomike për ekonomitë në tranzicion, procesin e transformimit dhe riorganizimit strukturor të ekonomisë shqiptare, teoritë ekonomike dhe modelet e zhvillimit, politikat dhe strategjitë e institucioneve ndërkombëtare, tregjet financiare, politikat monetare dhe bankat.

## IMPRINT

Fondacioni “Friedrich Ebert” | Rr. “Kajo Karafili”, Nd. 14, Hyrja 2, Kati 1 | Tiranë | Shqipëri

Përgjegjës:

**Stine Klapper** | Drejtoreshë e Fondacionit “Friedrich Ebert”, Zyra e Tiranës

Tel: +355 4 22 509 86 / 733 06

[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

Menaxhere Programi:

**Jonida Smaja**

Redaktimi letrar:

**Edlira Shuli**

Përdorimi tregtar i të gjitha materialeve mediatike të publikuara nga Fondacioni “Friedrich-Ebert” (FES) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES-it.

Realizimi i pyetësorit dhe përpunimet statistikore:

**Daniel Guçe**

**Anisa Hysesani**

# SISTEMI EKONOMIK DHE ROLI I SHTETIT NË SHOQËRI

## Opinione dhe qëndrime të publikut shqiptar



Qëllimi i këtij raporti studimor është analiza e perceptimeve të publikut mbi mënyrën e funksionimit të sistemit ekonomik e shoqëror, raportet ndërmjet shtetit dhe tregut, ndryshimet në sistemin e vlerave shoqërore që mund të jenë ravijëzuar gjatë tri dekadave të tranzicionit drejt një sistemi demokratik dhe ekonomisë së tregut, si dhe vlerësimet e publikut lidhur me proceset integruese në të cilat është angazhuar vendi.

Studimi bazohet në premisën e testu-



ar si nëpërmjet një pyetësoi të realizuar me mbështetjen e këtij projekti kërkimor, ashtu dhe nëpërmjet analizave empirike dhe teorike, se zhvillimi ekonomik i vendit ka krijuar diferenca të mëdha sociale dhe se një shoqëri harmonike dhe kohezive është thelbësore si për të rritur cilësinë e jetës në vend, ashtu dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e vetë sistemit ekonomik e shoqëror në afat të gjatë.

Disa gjetje kryesore të studimit janë:  
(i) Shpërndarja e pabarabartë e të ar-



dhurave dhe pasurisë në Shqipëri po cenon gjithnjë e më shumë kohezionin social të popullsisë; (ii) Sistemi është i disbalancuar në favor të kapitalit; (iii) Vetëm rreth 30% e popullatës mbështetin një shoqëri të bazuar mbi individualizmin; (iv) Për sa i përket rënies së standardit të mirëqenies, rreziku i perceptuar nga shoqëria vjen në rritje; (v) Vlerësohet thellimi i proceseve integruese dhe efektet e marrëveshjeve të tregtisë së lirë, duke nënkuptuar ruajtjen e kontrollit lokal mbi legjisllacionin e vendit.

Për më shumë informacion:

<https://www.fes-tirana.org/al/publikime/>